

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5915
E hënë, 28 tetor 2019
çmimi 0.40 €

Daci: Mirë që u ndërruan pushtetet, por nuk priten çudira



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", IMRI AHMETI | FAQE 4-5

S'ka pengesë për krijimin e qeverisë së re

- Vetëvendosja dhe LDK-ja do të ofrojnë qeverisje efektive dhe pa korrupsion

Zyrtari i lartë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Imri Ahmeti, ka thënë se nuk duhet të ketë vonesa për formimin e institucioneve të reja në përputhje me rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit. Ai ka thënë se, pavarësisht prej dallimeve, nuk ka asnjë pengesë

për krijimin e qeverisë së re në mes të Vetëvendosjes dhe LDK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ahmeti ka deklaruar se LV-ja dhe LDK-ja do të ofrojnë qeverisje të mirë, efektive dhe pa korrupsion. Megjithatë, ai ka thënë se qeverinë e re

e presin shumë sfida, përfshirë këtu vazhdimin e dialogut me Serbinë, zhvillimin ekonomik si dhe fuqizimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Ahmeti ka treguar se deri më tani nuk ka një marrëveshje ndërmjet dy subjekteve për ndarjen e pushtetit

'Mini-Schengen', jashtë procesit të Berlinit

Instituti EPIK ka reaguar lidhur me zhvillimet e fundit përkitazi me iniciativën e ashtuquajtur "Mini-Schengen". Ky institut ka shprehur shqetësimin për mungesën e vullnetit të sinqertë politik për t'i adresuar sfidat e identifikuar nga liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit, i cili është lansuar tanimë që pesë vjet. Në këtë drejtim Instituti EPIK ka shfaqur skepticizmin për nisjen e një procesi të ri, jashtë procesit të Berlinit, por me synime të njëjta



'Epoka e re' publikon raportin e institutit zviceran për rastin e vdekjes së Astrit Deharit

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

PAS REAGIMEVE KUNDËR KOMITETIT TË NOBELIT, T'I HEDHIM NJË VËSHTRIM VETVETES F. 8-9

Rexhep QOSJA



AKTUALE



VRITET LIDERI I SHTETIT ISLAMIK F. 11

TOMË GASHI: MIJËRA HERË KAM THËNË SE ASTRIT DEHARI ËSHTË VRARË F. 5

EKONOMI

ZVOGËLIMI I NUMRIT TË MINISTRIVE RREZIKON SHUMË VENDE TË PUNËS F. 7

LEKAJ: AUTOSTRADA E DUKAGJINIT NUK KA QENË PREMTIM ELEKTORAL F. 7

KULTURË

FILIGRANI PËRTEJ ARTIZANATIT F. 16

SPORT

BALLKANI UDHËHEQ SUPERLIGËN, '89-SHI SËRISH FITIMTAR NDAJ GJILANIT F.20

Daci: Mirë që u ndërruan pushtetet, por nuk priten çudira

PRISHTINË, 27 TETOR - Ish-kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Nexhat Daci, ka thënë se qytetarët presin gjithmonë që pushtetet e reja të jenë më efikase. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ai ka thënë se Qeveria e re e Kosovës duhet të tregohet e aftë për zgjidhjen e problemeve me të cilat përballen qytetarët. Sa i përket dialogut me Serbinë, Daci ka pohuar se do të ishte më se e domosdoshme përfshirja e opozitës. "Unë besoj se është shumë mirë kur në zgjedhje

ndërrohen garniturat. Është një freski, nuk do të thotë se janë më të mirë apo më të këqij, por qytetarët presin gjithmonë që pushtetet e reja të jenë më efikase apo duhet të jenë më efikase. Prandaj, unë mendoj se është bërë mirë që opozita i ka fituar zgjedhjet sepse vetëm në atë mënyrë faktikisht është lëvizja e ujit, nuk bëhet amull uji dhe kur bëhet amull, nuk pihet. Prandaj, zakonisht njerëzit presin që kur opozita të vijë, duhet të tregohet e aftë për zgjidhjen e problemeve që ka jeta e

njerëzve dhe shpresoj të kenë sukses", ka thënë Daci. Ai ka thënë se ka një zhgënjim të madh në bashkësinë ndërkombëtare. "Unë kam një zhgënjim të madh në bashkësinë ndërkombëtare. Premtime tepër të mëdha prej dhjetë vjetësh më parë deri tash. Për qarkullimin e lirë, për udhëtimin pa viza dhe asnjëherë nuk u përmbahen premtimeve e as vendimeve të forumeve më të mëdha, siç është Parlamenti Evropian e këto të tjerat. Prandaj, porosia ime ose këshilla ime për qever-

inë e re është që nën një të jenë interesat e Kosovës, të shtetasve të Kosovës dhe diku në renditje pika e dytë, e tretë, e katërt apo e pestë e bashkësisë ndërkombëtare. Mbani në mend, gjatë vite kam qenë kryetar i Parlamentit dhe përfaqësuesit specialë të cilët kanë qenë të plotfuqishëm si mbretërit, kanë thënë se për 24 orë do t'i keni..., i kanë pasur të gjitha funksionet dhe do të thotë kanë funksionuar ata si shtet dhe nuk kanë kryer asgjë. E shihini që sa vite që thotë 'kryeni edhe këtë detyrë do



ta merrni lëvizjen e lirë'. Sa e kryejmë atë detyrë, t'i shtojnë edhe pesë apo gjashtë të tjera. Prandaj, pushteti i ardhshëm ose qeveria e ardhshme nuk duhet të jetojë me premtime dhe nga premtime, por nga puna që bën", ka deklaruar Daci.

Kurti: Tensionet në raportet Kosovë -S erbi vijnë nga shqetësimi i tepërt i jashtëm diplomatik

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë në Samitin e Paqes në Tiranë, se tensionet në raportet midis Kosovës dhe Serbisë vijnë nga shqetësimi i tepërt me normalizimin e jashtëm diplomatik të marrëdhënieve midis dy shteteve tona teksa neglizhohet nevoja për normalizim të brendshëm demokratik të dy shteteve tona veç e veç

TIRANË, 27 TETOR (ER) - Në kuadër të punimeve të Samitit të Paqes për Evropën Juglindore që po mbahet në Tiranë, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ishte pjesë e panelit "Trajtimi i sfidave kritike të kohës sonë: Roli i parlamentarëve", ku morën pjesë edhe Erna Hennicot Shoopges, ish-kryetare e Parlamentit të Luksemburgut, Angela Guerra, deputete e Parlamentit të Portugalisë, Vasilika Hysin, zëvendëskryetare e Parlamentit të Shqipërisë, Jovan Jovanović, deputet i Parlamentit të Serbisë, dhe Ghazi Tayyeb, senator në Jordan dhe ish-komandant i forcave të OKB-së në Kroaci.

Në fjalën e tij Kurti ka theksuar se për republikën demokratike

është i rëndësishëm kuptimi që kanë deputeti dhe ministri duke iu referuar etimologjisë së fjalëve. "I pari, deputeti, si zëvendës i qytetarëve, pra përfaqësues nga pamundësia e pjesëmarrjes së gjithë popullit në Kuvend e jo nga dëshira për ta zëvendësuar popullin në shtet. Dhe, i dyti, ministri, si shërbyes i popullit dhe shtetit, pra shërbëtor i këtyre, madje me vetëdëshirë për të shërbyer, e kurrsesi sundues mbi ndokënd apo përfitues për çkado", ka thënë ai.

Po ashtu, Kurti ka vlerësuar se Kuvendi është vendi ku deputetët dhe qeveritarët, shumica dhe pakica, kanë të përbashkët hapësirën dhe mënyrën, mbledhjen ku arsyetojnë e argu-



mentojnë dhe dialogun e debatin me të cilin komunikojnë. Duke folur për rolin e parlamentit në marrëdhëniet ndërshtetërore dhe ato fqinjësore, lid-

eri i LV-së ka potencuar: "Tensionet në raportet midis Kosovës dhe Serbisë vijnë nga shqetësimi i tepërt me normalizimin e jashtëm diplomatik të

marrëdhënieve midis dy shteteve tona, teksa neglizhohet nevoja për normalizim të brendshëm demokratik të dy shteteve tona veç e veç".

Kryetari i bashkisë së Tiranës nderon Pendarovskin me "Çelësin e qytetit"

Tiranë, 27 tetor - Për vizitën e tij të parë zyrtare presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, zgjodhi pikërisht Tiranën, ku u prit në një takim nga kryebashkiaku Erion Veliaj. Veliaj i dorëzoi Pendarovskit "Çelësin e qytetit", si një dëshmi e një dëre të hapur dhe e një miqësie të gjatë mes dy vendeve. "Jam shumë i lumtur që mirëpres në qytetin e Tiranës, në Bashki, në shtëpinë tonë të përbashkët mikun tonë, vëllanë tonë, fqinjin tonë, Stevo

Pendarovski, presidentin e ri të Maqedonisë. Jam shumë i lumtur që ai ndan bindjen tonë se fqinjët e mirë janë bashkë në ditë të mira, por edhe në ditë të vështira. Tiranë është sot shtëpia edhe e shumë qytetarëve të Maqedonisë, ndihen të barabartë", ka thënë Veliaj. Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, i ka shprehur mirënjohjen kryebashkiakut Veliaj për nderimin me "Çelësin e qytetit". "Unë jam president i një

shteti shumetnik, edhe kryetari i qytetit të Shkupit është gjithashtu kryetar i një qyteti shumetnik. Respekti ndaj diversiteteve, prej të cilave është i formuar shteti dhe shoqëria jonë, është parakusht themelor për një përparim në shekullin XXI. Vërtet kam nderin dhe kënaqësinë që mora 'Çelësin e qytetit', sepse kurdo që të më sjellë rruga këndeje nga ju, në Tiranë sidomos, do të kem vendin ku të fle një natë", u shpreh Pendarovski.



'Mini-Schengen', jashtë procesit të Berlinit

Instituti EPIK ka reaguar lidhur me zhvillimet e fundit përkitazi me iniciativën e ashtuquajtur "Mini-Schengen". Ky institut ka shprehur shqetësimin për mungesën e vullnetit të sinqertë politik për t'i adresuar sfidat e identifikuar nga liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit, i cili është lansuar tanimë që pesë vjet. Në këtë drejtim Instituti EPIK ka shfaqur skepticizmin për nisjen e një procesi të ri, jashtë procesit të Berlinit, por me synime të njëjta



rajonale të bëhet çdo herë në frymë të gjithëpërfshirjes së të gjitha vendeve të rajonit, duke evituar kështu ndarjen e vendeve të Ballkanit në mes të vendeve që lansojnë iniciativa të bashkëpunimit rajonal dhe atyre që u bashkohen atyre, gjithnjë duke nënvizuar vullnetin e plotë të deklaruar të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor për bashkëpunim sa më të afërt me qëllim të forcimit të paqes, barazisë, shtetit së drejtës dhe prosperitetit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. "Shprehim shqetësimin për mungesën e vullnetit të sinqertë politik për t'i adresuar sfidat e identifikuar nga liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit, i cili është lansuar tanimë që pesë vjet. Në këtë drejtim shfaqim skepticizmin tonë për nisjen e një procesi të ri, jashtë procesit të Berlinit, por me synimet e njëjta. Në këtë drejtim nuk kemi arritur të kuptojmë se si një iniciativë e re politike, por me pjesëmarrje më të kufizuar politike se procesi i Berlinit, do të arrijë rezultate më të mira", është thënë në komunikatën e Institutit EPIK.

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 27 TETOR - Instituti EPIK ka përcjellë zhvillimet e fundit përkitazi me iniciativën e ashtuquajtur "Mini-Schengen". Duke marrë për bazë deklaratën e përbashkët të tre krerëve të shteteve që u mbledhën më 9 tetor të këtij viti në Novi Sad të Serbisë, kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, presidentit të Serbisë, Aleksandar Vučić dhe kryeministrit të Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, Instituti EPIK ka konstatuar se iniciativa është në përputhje me obligimet dhe ambiciet e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së.

Deklarata merr për bazë obligimet e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së: 1. Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit të gjashtë vendeve respektive; 2. Planin shumëvjeçar të veprimit për krijimin e Zonës Ekonomike Rajonale të lansuar në Samitin e Triestes si pjesë e Procesit të Berlinit; 3. Marrëveshjen CEFTA; dhe 4. Komunikatën e Komisionit Evropian "Një perspektivë e besueshme e zgjerimit për një angazhim të shtuar të BE-së me Ballkanin Perëndimor". "Deklarata me të drejtë njeht sfi-dat e Ballkanit Perëndimor: Bruto-Produkti Vendor (BPV) i BE-së, me çmimet e tregut,

është 100 herë më i madh se i gjashtë vendeve të Ballkanit; Niveli mesatar i papunësisë në BE është pothuajse tri herë më i ulët se në gjashtë vendet e Ballkanit; Kamionët humbasin afërsisht 26 milionë orë në vit në pikëkalimet kufitare brenda Ballkanit; Vonesat në kufi janë pesë herë më të gjata se në BE (Banka Botërore)", është theksuar në komunikatën e Institutit EPIK.

Sipas këtij instituti, në këtë drejtim, deklarata synon ta arrijë krijimin e tregut të përbashkët prej 20 milionë qytetarëve, eliminimin e kontrolleve kufitare dhe pengesave të tjera të lëvizjes së lirë jo më vonë se në vitin

2021, lëvizjen e lirë të qytetarëve të Ballkanit në rajon me kartë identiteti, të drejtën e punësimit të qytetarëve kudo në rajon, njohjen e ndërsjellë të diplomave në gjithë rajonin dhe ngritjen e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe ndihma në rastet e katastrofave natyrore. "Gjithashtu, duhet nënvizuar faktin se deklarata trajton Kosovën në nivel të barabartë sikur të gjitha vendet e tjera të rajonit", thuhet në komunikatën e Institutit EPIK.

Më tej, Instituti EPIK, duke vlerësuar iniciativën e ndërmarrë nga tre liderë të rajonit, ka bërë thirrje që lansimi i ideve

Bilall Sherifi thotë se Nisma e ka kaluar pragun 5 për qind

Sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka thënë se koalicioni Nisma-AKR-PD ka arritur të bëhet pjesë e Kuvendit duke arritur 5.017 për qind të votave, duke llogaritur votat e rregullta, ato me kusht dhe të diasporës

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 TETOR - Sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka bërë me dije se koalicioni Nisma-AKR-PD ka arritur të grumbullojë rreth 42 mijë vota. Sherifi ka thënë se nga votat e diasporës ky koalicion ka marrë 915 vota apo rreth 6.95 për qind, ndërsa nga ato me kusht dhe kategoria e personave me nevojë të veçanta 1 401 apo 5.55 për qind. Ai ka thënë se rëndësi e këtyre rezultateve është se në procesin e rinumërimit koalicioni Nisma-AKR-PD ka arritur që nga 844 kuti të rinumëruara të ketë 5.5 për qind të votave. Sherifi ka thënë se koalicioni Nisma-AKR-PD ka arritur të bëhet pjesë e Kuvendit duke

arritur 5.017 për qind të votave, duke llogaritur votat e rregullta, ato me kusht dhe të diasporës. "Ndërsa, nëse kemi parasysh se në vendin tonë janë lejuar disa zarfe në mënyrë ilegale të kontrabanduara në postën numër 6 dhe të dërguara në QNR pa asnjë vendim paraprak dhe pa asnjë raport paraprak të Prokurorisë, e cila i kishte në ekzaminim dhe pa një vendim të KQZ-së, sërish koalicioni ynë ka mbi 5 për qind të votave", ka thënë Sherifi. Po ashtu, ai ka thënë se Nisma do të insistojë që këto vota të cilat janë mbushur në mënyrë të jashtëligjshme dhe në mënyrë kriminale, pretendojnë të kthehen në vota të mos trajtohen nga KQZ-ja.

Gjithashtu, sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate ka thënë se



duke pasur parasysh trendin e votave të numëruara kanë arsye edhe më të fuqishme të vazhdojnë të kërkojnë rinumërim të të gjitha kutive për t'u dhënë përgjigje zgjedhësve. "Kushdo që pretendon që përmes votave kriminale ta hedhë poshtë vullnetin e 42 mijë votuesve që kanë

zgjedhur ta votojnë Nismën bëjnë gabim të rëndë dhe të ballafaqohen me pasojat që prodhon ligji. Demokracia në Kosovë është në sprovë në këto çaste. Kushdo që beson se Nisma do të rrijë duarkryq përballë këtij krimi zgjedhor gabon. Ne do t'i shfrytëzojmë të gjitha instancat ligjore

dhe nuk do të ndalemi derisa e drejta të fitojë. Askush në këtë vend dhe këta 42 mijë qytetarë nuk i kanë borxh askujt që për disa vota të jashtëligjshme që nuk i hyjnë në punë askujt të tentojnë ta lënë jashtë Kuvendit vullnetin e 42 mijë njerëzve", ka thënë Sherifi.

Flet për "Epokën e re", Imri Ahmeti

S'ka pengesë për krij

- Vetëvendosja dhe LDK-ja do të ofrojnë qeverisje efektive dhe pa korrupsion

Zyrtari i lartë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Imri Ahmeti, ka thënë se nuk duhet të ketë vonesa për formimin e institucioneve të reja në përputhje me rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit. Ai ka thënë se, pavarësisht prej dallimeve, nuk ka asnjë pengesë për krijimin e qeverisë së re në mes të Vetëvendosjes dhe LDK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ahmeti ka deklaruar se LV-ja dhe LDK-ja do të ofrojnë qeverisje të mirë, efektive dhe pa korrupsion. Megjithatë, ai ka thënë se qeverinë e re e presin shumë sfida, përfshirë këtu vazhdimin e dialogut me Serbinë, zhvillimin ekonomik, si dhe fuqizimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Ahmeti ka treguar se deri më tani nuk ka një marrëveshje ndërmjet dy subjekteve për ndarjen e pushtetit



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 TETOR - Zyrtari i lartë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), njëherësh kryetar i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka thënë të dielën se kjo parti ka shënuar rritje në zgjedhjet e 6 tetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se votat që i ka marrë LDK-ja në procesin zgjedhor janë vlerësim dhe besim nga qytetarët për programin tonë. "Natyrish se në garë kemi hyrë për t'i fituar zgjedhjet, por nuk ia dolëm të dalim partia e parë. Megjithatë, pritjet tona kanë qenë që të jemi fitues të kësaj gare. Votat që i kemi marrë janë vlerësim dhe besim i qytetarëve të Republikës së Kosovës për programin dhe kandidatët tanë.

Mendoj se kemi pasur një përparim jashtëzakonisht të mirë, por është dashur të punohet në mënyrë që të jemi të parët", ka deklaruar Ahmeti, duke shtuar se ende nuk dihen arsyet pse LDK-ja nuk i ka fituar zgjedhjet. "Në fakt, nuk kemi një vlerësim për këtë, sepse ende nuk është mbledhur kryesia e partisë. Vetëm pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 6 tetorit do të ulemi për t'i parë mangësitë tona në organizimin që kemi pasur në terren në mënyrë që pastaj të nxjerrim një bilanc të kësaj situatë në të gjitha degët e LDK-së në Kosovë dhe jashtë Kosove. Pas certifikimit të rezultateve sigurisht se do të dalim me një analizë më të saktë për rezultatin e LDK-së. Tani për tani nuk kemi një konkluzion të përbashkët lidhur me rezultatin e LDK-së të

arritur më 6 tetor", është shprehur ai. Sidoqoftë, Ahmeti ka thënë se LDK-ja ka marrë mbështetjen e qytetarëve për të qenë pjesë e qeverisë. Megjithatë, ai ka thënë se qeverisja në vend gjithmonë është sfiduese pavarësisht se me cilin subjekt qeveris. "Sfidat nuk janë të vogla për qeverinë e ardhshme, mirëpo LDK-ja ka kapacitete dhe ka njerëz kompetentë për të marrë përgjegjësi të caktuara brenda qeverisë së ardhshme", ka theksuar Ahmeti.

"Epoka e re": Z. Ahmeti, çfarë vlerësimi keni për zgjedhjet e 6 tetorit dhe a ka qenë i pritur rezultati që ka marrë LDK-ja në këtë proces zgjedhor?

Ahmeti: Natyrish se në garë kemi hyrë për t'i fituar zgjedhjet, por nuk ia dolëm të dalim partia e parë. Megjithatë, pritjet tona kanë qenë që të jemi fitues të kësaj gare. Votat që i kemi marrë në procesin zgjedhor të 6 tetorit për neve janë vlerësim dhe besim nga qytetarët për programin tonë.

"Epoka e re": Cilat mendoni se kanë qenë arsyet që kanë ndikuar që LDK-ja të mos dalë e para?

Ahmeti: Në fakt, nuk kemi një vlerësim për këtë, sepse ende nuk është mbledhur kryesia e partisë. Vetëm pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 6 tetorit do të ulemi për t'i parë mangësitë tona në organizimin që kemi pasur në terren në mënyrë që pastaj të nxjerrim një bilanc të kësaj situatë në të gjitha degët e LDK-së në

Ramadani: Rusia e Serbia po kërcënojnë Ballkanin

Prishtinë, 27 tetor (ER) - Zëvendësministri në detyrë i Mbrojtjes, Burim Ramadani, ka thënë se Rusia dhe Serbia janë duke kërcënuar paqen në Ballkan. Ai ka thënë se këto dy shtete janë duke kërcënuar Ballkanin përmes demonstrimit të forcës, duke vendosur sistemet rakitore ruse në Serbi. "Tashmë edhe një herë përmes së ashtuquajturës 'Mburoja

sllave', boshti i së keqes ndaj Ballkanit po kërcënon përmes demonstrimit të forcës. Madje duke vendosur në Serbi edhe sistemet rakitore ruse. Sigurisht se e drejta sovranë e një shteti nuk përfshin kërcënimin ndaj fqinjëve në bashkëpunim me kundërshtaren kryesore të NATO-s, Rusinë. Orientimi pro-perëndimor dhe pro-NATO i Ballkanit është i vetmi orientim

që garanton paqe të përherëshme. Lojërat e tjera, si edhe kjo e fundit, dëmtojnë raportet në rajon dhe nxisin tensione edhe më tutje. Serbia duhet të marrë përgjegjësinë për krimet që ka kryer në Ballkan. Ushtria e saj duhet të dekriminalizohet përfundimisht dhe të distancohet nga trashëgimia gjenocidiale", ka shkruar Ramadani në llogarinë e vet në "Facebook".



imin e qeverisë së re



Kosovë dhe jashtë Kosovës. Pas certifikimit të rezultateve sigurisht se do të dalim me një analizë më të saktë për rezultatin e LDK-së. Tani për tani nuk kemi një konkluzion të përbashkët lidhur me rezultatin e LDK-së të arritur më 6 tetor.

"Epoka e re": Edhe pse nuk keni fituar, megjithatë në këto zgjedhje LDK-ja ka shënuar ngritje.

Ahmeti: Votat që i kemi marrë

janë vlerësim dhe besim i qytetarëve të Republikës së Kosovës për programin dhe kandidatët tanë. Mendoj se kemi pasur një përparim jashtëzakonisht të mirë, por është dashur të punohet në mënyrë që të jemi të parët. Si duket besueshmëria e qytetarëve kësaj radhe ishte pak më e madhe për Vetëvendosjen sesa për LDK-në. Megjithatë, e pranojmë këtë rezultat dhe do të vazhdojmë tutje.

"Epoka e re": Ky rezultat i mundëson LDK-së ardhjen në qeveri. Ajo është duke i zhvilluar negociatat me Lëvizjen Vetëvendosje. Si po ecën procesi i negociatave dhe ju personalisht si e shihni formimin e qeverisë LV - LDK?

Ahmeti: Shumica e qytetarëve që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e 6 tetorit ua kanë dhënë besimin këtyre dy partive për të qeverisur. Meqenëse Vetëvendosja është subjekti i parë, atëherë LDK-ja është e gatshme që të hyjë në proces të bashkëqeverisjes për t'i marrë përgjegjësitë e veta në qeverinë e re.

"Epoka e re": Sa do të jetë sfiduese për LDK-në qeverisja me Vetëvendosjen duke pasur parasysh dallimet që kanë këto dy parti?

Ahmeti: Qeverisja në vend gjithmonë është sfiduese pavarësisht se me cilin subjekt qeverisë. Sfidat nuk janë të vogla për qeverinë e ardhshme, mirëpo LDK-ja ka kapacitete dhe ka njerëz kompetentë për të marrë përgjegjësi të caktuara brenda qeverisë së ardhshme. Tani për tani nuk ka një ndarje dhe një marrëveshje të saktë se me cilat resorë do të udhëheqë LDK-ja, por cilat do qofshin ato, për neve është prioritet situata në vend dhe agjenda e përbashkët me fokus për një mirëqenie më të mirë për qytetarët. Nuk është në interes të veçantë as të LDK-së dhe as të Vetëvendosjes se çfarë ministrie marrin ata apo ne. Më e rëndësishme se kjo është krijimi i një platforme për një qeverisje më të mirë.

"Epoka e re": Deri më tani LV-ja dhe LDK-ja nuk kanë arritur të përcaktohen për ndarjen e asnjë pozite qeveritare?

Ahmeti: Ende nuk ka një marrëveshje ndërmjet dy subjekteve. Tani për tani po bisedohet në kuadër të grupeve të ekspertëve për ta harmonizuar programin e qeverisë së

ardhshme. Ndërkaq më vonë sigurisht se do të arrihet edhe marrëveshja politike për ndarjen e resorëve, përkatësisht sektorëve qeverisës.

"Epoka e re": Qeverinë e drejtuar nga LV-ja dhe LDK-ja e presin shumë sfida. Një ndër to, dialogu me Serbinë. Besoni se kjo qeveri do të mund t'u bëjë ballë me sukses këtyre sfidave? **Ahmeti:** Është e vërtetë se këtë qeveri e presin shumë sfida, por ato nuk janë veç të qeverisë, por janë të gjithë shoqërisë. Sigurisht se vazhdimi i dialogut me Serbinë është një ndër sfidat që ka qeveria e re. Përveç kësaj, një sfidë jashtëzakonisht e vështirë është zhvillimi ekonomik i vendit, përmirësimi i gjendjes në shëndetësi, arsimi si dhe të gjitha fushat e tjera. Sfidë do të jetë edhe fuqizimi i shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Prandaj konsideroj se sfidat nuk duhet të ndahen në qeveri dhe jo qeveri, por sfidat janë të shoqërisë dhe, si të tilla, duhet t'i shohim në vijim të angazhimeve tona të përbashkëta.

"Epoka e re": Ekziston ndonjë çështje për të cilën nuk do të mund të ketë pajtueshmëri në mes të LDK-së dhe LV-së?

Ahmeti: Nuk mendoj se do të ketë diçka që do të mund të ishte pengesë për krijimin e një qeverie të përbashkët. Mendoj se ka shumë pika të përbashkëta dhe po bisedohet për ta gjetur zgjidhjen e përbashkët për të gjitha situatat.

"Epoka e re": E kaluara e këtyre dy subjekteve dhe kritikën që kanë shkëmbyer gjatë mandateve të kaluara nuk do të paraqesin probleme në rrugëtimin e tyre të përbashkët në pushtet?

Ahmeti: Nuk duhet të kthehet mbrapa askush. E rëndësishme është që të shikohet përpara dhe të gjendet formula për të bërë më të mirën për Kosovën

dhe qytetarët e saj. Nuk duhet të kthehemi kah e kaluara, por duhet të merremi me të ardhmen dhe me agjendën e përbashkët e cila avancohet dhe përmirëson çdo sektorë në Kosovë.

"Epoka e re": Kryetar, meqë qytetarët ua kanë dhënë besimin këtyre dy partive për ta qeverisur vendin gjatë mandatit të ardhshëm, cili mendoni se duhet të jetë prioriteti kryesor i qeverisë së re?

Ahmeti: Prioritetet e qeverisë së ardhshme do t'i specifikojë mandatarin për kryeministër bashkë me qeverinë, por në horizont shihen shumë probleme me të cilat duhet të ndeshemi. Besoj se në ditët në vijim dy partitë do të dalin me prioritetet e qeverisjes së ardhshme. Vetëvendosja dhe LDK-ja duhet të ofrojnë një qeverisje të mirë, efektive dhe pa korrupsion.

"Epoka e re": Vetëvendosja dhe LDK-ja do të qeverisin më mirë se PAN-i?

Ahmeti: Gjithsesi se do të qeverisin më mirë. Të metat e ish-qeverisë nuk do të përsëriten. Mendoj se është krijuar një situatë e re politike në të cilën do të mund të formohet një agjendë e përbashkët e cila do të sigurojë një qeverisje me duar të pastra dhe e cila do t'i qaset plotësisht realizimit të çdo pike të agjendës së përbashkët.

"Epoka e re": Mund të ketë vonesa deri në krijimin e kësaj qeverie?

Ahmeti: Nuk mendoj se ka nevojë të vonohet formimi i institucioneve të reja. Afatet e përcaktuara ligjore duhet t'i respektojmë, por çdo tendencë për të krijuar vonesa të panevojshme apo për t'iu shmangur rezultatit të 6 tetorit nuk prodhon të mira për vendin tonë. Prandaj sa më parë duhet të konstituohet Kuvendi, pastaj të formohet qeveria e re.

Tomë Gashi: Mijëra herë kam thënë se Astrit Dehari është vrasë

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Avokati i familjes Dehari, i angazhuar për ta zbardhur rastin e vdekjes së veprimtarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, Tomë Gashi, ka thënë se tash e tri vjet mijëra herë ka deklaruar se trupi i Astrit Deharit vërtetohet vrasjen e tij. Në llogarinë e vet në "Facebook", Gashi ka publikuar një video të një konference të tij

kur kishte thënë se Astrit Dehari është vrasë. "Që nga dita e vrasjes më 5 nëntor 2016 e kam thënë me mijëra herë se trupi i Astrit Deharit e vërteton vrasjen. Janë mbi 460 000 faqe që e kanë publikuar këtë. Dhe janë më shumë se 50 000 000 / pesëdhjetë milionë/persona që e kanë lexuar këtë se Astrit Dehari është vrasë. Por u deshtë me prit tri


vjet që edhe vrasësit të binden se e kanë vrasë Astritin. Kjo është një nga konferencat e para më 16 dhjetor 2016 ku me fakte shkencore nga ekspertiza e ekspertëve të pavarur, dhe si përgjigje ndaj mohimit të vrasjes nga ana e zyrtarëve shtetërorë, të cilët me shpirtin e tyre të zi e mohonin atë që e dinin më mirë se unë", ka shkruar Tomë Gashi.



Sot mbahet marshi në përkujtim të Astrit Deharit

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Sot (e hënë) do të mbahet një aktivitet simbolik në përkujtim të Astrit Deharit, i cili ka vdekur në vitin 2016 në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Ky marsh pritet të fillojë në orën 18:00 në rrugën "Rexhep Luci" (afër Kino ABC) në Prishtinë, aty ku është ngritur murali përkujtimor për Astritin. "Do të mblidhemi së

bashku në një aktivitet përkujtimor për ta shprehur solidaritetin dhe dhimbjen tonë me familjen Dehari. Familja Dehari do të mbajë një fjalë rasti. Për kujtimin ndaj Astritit do ta mbulojmë rrugëkalimin me qirinj, lule dhe kartolina me mesazhe për familjen e tij", është thënë në njoftimin e grupit organizativ të marshit "Unë jam Astriti!"



Koordinatori Hoti viziton nxënësit fitues në kampin kreativ njëjavor

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Rexhep Hoti, Koordinator Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, ka vizituar nxënësit fitues të garave republikane të cilët kanë mbajtur kampin kreativ njëjavor. Koordinator Hoti fillimisht u takua me mesimdhënësit që shoqëruan nxënësit, të cilët i falënderoi për angazhimin e tyre si gjatë procesit të garave, po ashtu edhe për kujdesin ndaj nxënësve gjatë kampit. Nga ana e tyre, mesimdhënësit thanë se garat e tilla në nivelin shtetëror kanë qenë shumë të nevojshme për sistemin arsimor dhe për nxënësit. Po ashtu, ata treguan përvojën e tyre në kampin kreativ, me ç'rast thanë se është një organizim shumë i veçantë për nxënësit.


Në fjalimin e tij drejtuar nxënësve fitues republikanë koordinatori Hoti ka thënë e ndihet i nderuar duke qenë në mesin e mendjeve të ardhshme të kombit. "Ju së bashku me mesimdhënësit, duke e ndërtuar si duhet mesimin mbi njohjen, kreativitetin, lëvizjen, realisht e keni bërë gjënë më të mirë për veten tuaj. Ne si shtet, si qeveri, nuk kemi asgjë më të çmueshme se ju sepse duke investuar në ju, kemi investuar në zhvillim ekonomik, në sundim të ligjit, në të drejta të njeriut, në shkencë e kudo tjetër. Ju tashmë jeni në fazën kur do të merrni shumë nga jeta, kudo që shkoni. Edhe ky kamp do t'ju përcjellë kudo që shkoni dhe unë ju garantoj se sa më shumë që në jetë të keni gjëra të tilla do të jenë terapitë

më të bukura që do t'ju mbesin në mendje dhe zemër. Mësohuni që në zemrat tuaja t'i mban gjërat e bukura e jo ato të ligat. Mësohuni në jetë që dijen dhe vlerat tuaja t'i ndani me të tjerët dhe kështu do të arrini shumë edhe ju edhe Kosova", ka thënë Hoti.

Për më shumë, mbi 400 nxënës fitues të garave republikane të klasave VI-XIII ishin pjesë e kampit kreativ nga 29 komuna të Kosovës si shpërblim.

Nën organizimin e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport tashmë janë duke u zhvilluar Gara Nacionale në Kreativitet Kulturor e Mendim Kritik si dhe Gara Nacionale në Sport ku të gjithë nxënësit nga klasa e I deri në të XII kanë mundësi të marrin pjesë.

Një kompanisë së ndërtimit në Prishtinë i ndërpriten punimet dhe gjobitet me 500 euro



PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ka shqiptuar një gjobë prej 500 eurosh ndaj një kompanie e cila nuk e ka respektuar lejen e ndërtimit, duke bërë që të shembet rruga "Sami Plakolli" në kryeqytet. Kjo komunë ka njoftuar se kësaj kompanie i janë ndërprerë punimet si dhe është urdhëruar që ta rregullojë shembjen e rrugës në fjalë. "Sot jemi njoftuar për një rrëshqitje të dheut në rrugën 'Sami Plakolli'. Menjëherë kanë dalë në vendin e ngjarjes dy ekipe të Inspeksionit, një nga Sektori i Rendit Komunal dhe një nga Sektori i Ndërtimit. Pala në këtë rast nuk e ka respektuar lejen ndërtimore sepse ende nuk e ka

ndërtuar murin mbrojtës. Si rrjedhojë, inspektori kujdestar nga sektori i ndërtimit e ka obliguar që t'i ndërpresë të gjitha punimet si dhe e ka shqiptuar gjobën në vlerë 500 euro. Inspektori kujdestar i sektorit të rendit komunal e ka shqiptuar gjobën tjetër për dëmtim të rrugës, gjithashtu 500 euro, si dhe e ka urdhëruar palën që menjëherë ta rikthejë terrenin në gjendjen e mëparshme. Vazhdimi i punimeve në ndërtimin e këtij objekti do të jetë i mundur vetëm pasi të vendoset muri mbrojtës sipas lejes ndërtimore dhe pasi të rregullohet pjesa e dëmtuar e rrugës", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



Suhareka përkujton Ukë Bytyçin

SUHAREKË, 27 TETOR (ER) - "Kujtimi për Ukë Bytyçin është skica e ngjarjeve që ka t'përbashkët fuqinë e bashkimit. Tregimi për të është fuqia e veprës dhe e fjalëve që nuk e humbën kurrë shkëlqimin", ka thënë kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, me rastin e 17-vjetorit të vrasjes

së Ukë Bytyçit. Ai ka thënë se Ukën secili do ta mbajë mend gjatë si njeriun modest e guximtar. "Idealistin e pamposhtur, luftëtarin sypatrembur dhe pa dyshim atë që s'e harruam kurrë, pamjen madhështore të një lideri të pazëvendësueshem. Liria e demokracia nuk ishin dikur

vetëm rrugëtimi i tij, ai u sakrifikua për to. Ecja e tij maratone ka krijuar vetë historinë e Therandës. Si shok, bashkëveprimtar e bashkëluftëtar do ta mbaj mend gjatë për t'ia treguar secilit madhësinë e tij dhe sigurisht edhe dhimbjen e së djeshmes, të sotmes dhe të ardhmes për mungesën e tij",

ka thënë kryetari Muharremaj. Muharremaj ka thënë se Ukë Bytyçi u vra, por nuk vdiq kurrë për atdheun. "Dy shoqëruarit e tij, Bafti Bajramaj dhe Bajram Bytyçi, po ashtu populli nuk i harron kurrë. Ai do të mbetet gjithmonë njeriu që na dha vullnet dhe e bëri të paharrueshëm rrugëtimin e tij drejt lirisë dhe



ndërtimit të vendit", ka deklaruar Muharremaj.

Zvogëlimi i numrit të ministrive rrezikon shumë vende të punës

PRISHTINË, 27 TETOR - Projektionet e dy partive që po negociojnë rreth formimit të koalicionit qeverisës, Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për përgjysmimin e numrit të ministrive të qeverisë së ardhshme, nga 21 ministri sa janë aktualisht në 12, mund të sjellë shkurtim të shërbyesve civilë në institucionet e Kosovës, thonë përfaqësues të shoqërisë civile.

Në takimet e zhvilluara ndërmjet këtyre dy subjekteve politike, në të cilët po negociohet arritja e një marrëveshjeje për formimin e qeverisë së re, është diskutuar për shkurtimin e numrit të ministrive sipas projekcionit të bashkimit të dy e më shumë ministrive në një. Të dy partitë tanimë kanë deklaruar se synojnë që qeveria e re të mos ketë më shumë se 12 ministri, duke besuar se zvogëlimi i numrit të ministrive nuk do të ketë si pasojë edhe shkurtimin e numrit të shërbyesve civilë.

Por, përfaqësues të shoqërisë civile e shohin paksa problematike realizimin e këtij synimi. Ndonëse konsiderojnë se është e nevojshme të zvogëlohet numri i ministrive, njëherësh besojnë se do të shkurtohet edhe numri i shërbyesve civilë. Drejtori i organizatës joqeveritare "Çohu", Arton Demhasaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se shkurtimi i ministrive dhe bashkimi i tyre, rrjedhimisht mund të përcillet edhe me shkurtim të stafit. "Është e pakuptimtë që një numër aq i madh i stafit që ekziston në ministri, kur të bëhen bashkë (dy ministri në një), numri i këtij stafi të mbetet i njëjtë dhe të mos shkurtohet. Secila ministri i ka burimet njerëzore, ka zyrtarë për informim apo pozita të tjera që në një ministri të bashkuar nuk ka nevojë të ketë aq shumë staf. Ky do të jetë problemi dhe sfida

kryesore e bashkimit të ministrive sesa bashkimi i vet stafit politik apo bashkimi i ministrive", ka pohuar Demhasaj.

Numri i të punësuarve në sektorin publik është rreth 82 mijë persona. Paga mesatare në sektorin publik, sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2018 ishte 573 euro.

Mexhide Demolli-Nimani, drejtoreshë e Lëvizjes FOL, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" ka theksuar se nëpër ministri ka shumë të punësuar me kontratë mbi vepër, të cilët, siç thotë ajo, me zvogëlimin e numrit të ministrive do të mund të shkurtohen si vende pune. "Zvogëlimi i numrit të ministrive do ta shkurttojë numrin e të punësuarve. Ministrinë kanë shpallur konkurse në javët e fundit, gjë që na ka bërë të mendojmë se ato kanë nevojë për punëtorë, prandaj ndoshta me një strategji të mirëfilltë secili punëtor do të sistemohet në mënyrë që të mos ketë largime masive të punëtorëve nga puna", ka thënë Demolli.

Demolli ka theksuar se Kosovës i duhet Ligji për Qeverinë, i cili, sipas saj, do ta rregullonte numrin e ministrive dhe shumë çështje të tjera.

Ndërkaq Arton Demhasaj thotë se në rast të shkurtimit të stafit do të rriteshin edhe pakënaqësitë e shërbyesve dhe do të krijoheshin probleme të mëdha. "Mund të ngritën edhe padi nëse largohen njerëzit nga puna. Ata kanë kontratë me ministrinë dhe në momentin kur ata mund të largohen nga puna, mund ta padisin qeverinë dhe mund ta fitojnë rastin për shkak se nuk është faji i tyre që është bërë eksperiment vazhdimisht me qeverinë, herë duke u rritur numri i ministrive, herë duke u zvogëluar. Pra, duhet një ligj për qeverinë, të punësuarit nuk janë



fajtorë dhe për këtë arsye ky është problemi kryesor", është shprehur Demhasaj.

Në një studim të bërë nga Instituti për Hulumtime të Avancuara GAP është thanë se me zvogëlimin e qeverisë sipas premtimeve zgjedhore të partive Vetëvendosje (LVV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), sipas kalkulimeve, buxheti i Kosovës do t'i kursente rreth 15.5 milionë euro për një mandat qeverisës.

Zyrtarët e Bashkimit Evropian në vazhdimësi kanë kërkuar refor-

ma në administratën publike në Kosovë si një prej kriterëve për vendet aspirante që një ditë duan ta marrin statusin e kandidatit për anëtarësim në BE.

Përfaqësues të shoqërisë civile kanë theksuar se administrata publike është e mbipopulluar me përkrahës të partive politike dhe kjo është arsyeja që institucionet kompetente po e neglizhojnë reformën në administratën publike.

Shumë pozita zyrtare në administratën publike në Kosovë në vazhdimësi ishin konsideruar të

panevojshme nga përfaqësues të shoqërisë civile. Ata kishin theksuar se punësimi i personave në postet publike, me apo pa nevojë, ndërlidhet edhe me marrëveshjet politike që partitë i arrijnë gjatë kohës së formimit të koalicioneve qeverisëse.

Në hulumtimet e bëra nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë ishte theksuar se lidhjet familjare, ryshfeti dhe lidhjet partiake, janë faktorët më të rëndësishëm për të siguruar një vend pune në administratën publike në Kosovë.

Lekaj: Autostrada e Dukagjinit nuk ka qenë premtim elektoral




PRISHTINË, 27 TETOR - Ministri në detyrë i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka thënë se autostrada e Dukagjinit nuk ka qenë vetëm premtim elektoral i qeverisë Haradinaj, por ajo do të ndodhë pavarësisht prej ndryshimeve në qeveri. "Projekti i autostradës së Dukagjinit nuk qenë vetëm premtim elektoral i qeverisë Haradinaj. Ky projekt ju them se do të ndodhë. Ky projekt është gjigand në të mirën kombëtare dhe ndërshtetërore dhe normalisht që drejtpërdrejt ndikon në jetën e 650 mijë qytetarëve të asaj zone të Kosovës", ka deklaruar Lekaj.

Ministri Lekaj më tutje ka shtuar se projektioni dhe obligimet nga ministrinë dhe qeveria janë kryer si dhe ka treguar për shumën e zotuar dhe planifikuar të fazës së parë. "Janë 70 milionë euro të planifikuara për vitin e ardhshëm për autostradën e Dukagjinit. Nga ana ministrorë dhe qeveritare çështja ka hyrë në binar. Gjithçka ka ndodhur me miratimin e legjislaturës së gjashtë. Tani i mbetet Kuvendit të ri ta vazhdojë procedimin e mëtejshëm. Ajo që ju siguroi edhe një herë, autostrada e dukagjinit do të ndodhë pavarësisht prej ndryshimeve pas 6 tetorit", ka thënë Lekaj për "radio1".

PAS REAGIMEVE KUNDËR KOMITETIT TË NOBELIT, T'I HEDHIM NJË VËSHTRIM VETVETES

Peter Handke! Çmimi Nobel!



Rexhep QOSJA

Qe më tepër se tri javë Peter Handke ishte emër shumë i shpeshtë në fjalorët e disa politikanëve, disa ministrave, disa deputetëve, disa diplomatëve, disa ambasadorëve, i kryetarëve e i kryeministrave dhe i disa shkrimtarëve tanë, mes të cilëve, me një deklaratë të shkurtër, të zbehtë, isha edhe unë.

Me Peter Handken unë jam marrë, po ashtu shkurtimisht, edhe para luftës e në kohën e luftës sonë çlirimtare, kur shumica e atyre që tani u morën me të, ndoshta nuk ia kishin dëgjuar emrin.

Qe më tepër se tri javë Peter Handke u bë emri aq i shpeshtë në fjalorët politikë, diplomatikë, letrarë e shkencore të politikanëve, shtetarëve, shkrimtarëve e krijuesve tanë të tjerë sepse iu dha Çmimi Nobel.

Po të mos iu kishte dhënë ky Çmimi ai, Peter Handke, do të mbetej i panjohur, i harruar për gojëtarët tanë të përmendur, siç kishte qenë i harruar e i panjohur më parë me gjithë veprimtarinë e tij politike që tani po quhet veprimtari kriminal.

Sigurisht se nuk kam pasur mundësi të mësoj se sa u fol për Peter Handken e nobelizuar në kontinente e në vende të tjera, por, megjithatë, mund të them se në asnjë vend tjetër në Evropë e në kontinente të tjera, politikanët, shtetarët dhe diplomatët nuk i kushtuan kujdes siç i kushtuan politikanët, shtetarët, diplomatët, shkrimtarët, krijuesit tanë të tjerë dhe dy akademitë tona: ajo e shkencave e Shqipërisë dhe ajo e shkencave dhe e arteve e Kosovës!

Duket se politikanët, shtetarët, diplomatët, shkrimtarët, e krijuesit e tjerë dhe akademitë e shkencave dhe të shkencave e të arteve të vendeve të tjera kishin punë më të rëndësishme

për të sotmen e të ardhmen e vendeve të tyre e të popujve të tyre sesa të merreshin me Peter Handken gjerë e gjatë. Politikanët, shtetarët, diplomatët e vendeve të tjera si duket u kujdesen të mos e shkëlqin një parim të rëndësishëm, shumë të rëndësishëm, të demokracisë moderne: mospërzierjen e tyre politike, shtetërore e policore, në vlerat artistike të krijimtarisë shpirtërore dhe në lirinë e mendimit e të shprehjes të krijuesve letrarë, artistikë e shkencorë.

Peter Handke është poet, prozator, skenarist, përkthyes, që ka shkruar një numër veprash, që janë çmuar vepra me vlera artistike, të pangarkuara, domethënë të pacenuara, prej ideologjive dhe politikave totalitare, despotike, tiranike, diktatoriale.

Këto vepra të tij letrare artistike, siç mund të jetë menduar në Komitetin Nobel e në Akademinë Mbretërore të Suedisë, i kanë plotësuar tri kriteret, që përcaktojnë përzgjedhjen e veprave që do të çmohen me Çmimin Nobel, e që janë: e para, vlera letrare artistike, e dyta, risitë formale e strukturore dhe, e treta, humanizmi.

Por, këto tri vlera të veprës letrare artistike të Peter Handkes, të pacenuara nga veprimtaria e tij publike, politike para fillimit të luftës në ish Jugosllavinë, ai i njollosi mbasi filloi kjo luftë e, sidomos, mbasi kjo luftë u përshtri në Bosnjë e Hercegovinë e në Kosovë.

Duke e përkrahur Kryetarin e Jugosllavisë së shkurtuar (Serbia e Mali i Zi) e mandej, kryetar i Serbisë, kasapin e Ballkanit, Sllobodan Millosheviqin, duke pranuar të jetë dëshmitar mbrojtës i tij në Gjykatën e Hagës, duke mbajtur fjalim në varrimin e tij në Serbi, Peter Handke, si qytetar, si intelektual, si shkrimtar e harroi misionin e krijuesit letrar dhe përkrahu dhunën e terrorin e tij, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit që bëri regjimi i Millosheviqit, sidomos në Bosnjë e Hercegovinë e në Kosovë.

I përkrahu me gojë! I përkrahu me veprimtari politike! I

përkrahu si gazetar e publicist! Por, i përkrahu pa armë në dorë, i përkrahu ndryshe nga shkrimtari rus i quajtur Limonov, i cili serbët në Bosnjë i përkrahu duke u veshur në uniformë ushtarake e duke u armatosur me kallash!

Pavarësisht se duke përkrahur Millosheviqin dhe regjimin e tij hapur përkrahu dhunë, terror, krime luftime e krime kundër njerëzimit, dhe e turpëroi ashtu gjithë krijimtarinë e tij intelektuale, Peter Handke u "ngushëllua" dhe u përpoq të ngushëllojë edhe të tjerë se këtë përkrahje e shprehu në sajë të së drejtës së krijuesve të krijimtarisë shpirtërore për mendim e shprehje të lirë, të pandaluar, të pacensuruar!

Duke e pasur parasysh të drejtën e krijuesve, të cilët veprën e tyre letrare, pra thjesht letrare, nuk e kanë cenuar me përbajtje, me ideologji e me politikë totalitare, tiranike, despotike, diktatoriale, ksenofobe a raciste, Komiteti Nobel dhe Akademia Mbretërore e Suedisë edhe ia dha çmimin Nobel Peter Handkes.

Ashtu siç e thonë disa teorikë, e theksoj, vetëm disa teorikë të letërsisë, ashtu edhe Akademia Mbretërore e Suedisë e shkëputi plotësisht veprën letrare artistike të Peter Handkes prej krijimtarisë dhe deklaratave të tij publike jashtëletrare!

Politikanët, shtetarët, diplomatët, shkrimtarët, krijuesit tanë të tjerë dhe akademitë tona të shkencave dhe të shkencave e të arteve kërkuan prej asaj Akademie t'ia anulojë Çmimin Nobel Peter Handkes. Dhe, kur e bënë këtë kërkesë harruan diçka: harruan çka nuk do të duhej të harronin! Harruan se kjo Akademi nuk ia kishte anuluar Çmimin Nobel shkrimtarit të shquar norvegjez, Knut Hamsun, të cilit ky Çmim i ishte dhënë në vitin 1920, por ai në fillim të Luftës së Dytë Botërore kishte përkrahur me gojë e me dorë nazizmin dhe Hitlerin! Norvegjia e kishte shpallur tradhtar të Kombit, Knut Hamsunin, por, megjithatë, nuk e kishte pushkatuar.

Dhe harruan çka nuk do të duhej të harrohej: harruan se Akademia Mbretërore e Suedisë nuk ia kishte anuluar Çmimin Nobel për paqe kryeministres së Birmanisë, Aung San Suu Kyi, e cila, jo shumë kohë mbasi iu dha ky Çmim, mori pjesë në vrasjet

masive dhe zhvendosjen e dhunshme të myslimanëve Rohingya prej Birmanisë!

Harruan dhe çka krejt tjetër nuk harruan politikanët, diplomatët, shkrimtarët, krijuesit tanë të tjerë dhe dy akademitë tona - Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës kur kërkuan t'ia anulohet Çmimi Nobel Peter Handkes.

Harruan t'ia lënë pak çaste të pushojnë Komitetin Nobel, Akademinë Mbretërore të Suedisë, Çmimin e saj Nobel dhe të nobelizuarin Peter Handke. T'ia lënë shkurt të pushojnë ato tri institucione suedeze e austriakun e nobelizuar për letërsi dhe t'ia hedhin një sy të djeshmes dhe të sotmes sonë politike, letrare, shkencore, kulturore, dhe, natyrisht jetëshkrimeve, veprimeve, veprave të disa figurave tona politike, shtetërore, letrare, artistike, shkencore.

Sikur t'ua hidhnin syrin këtyre figurave tona politike e krijuese, kësaj të djeshmeje e kësaj të sotmeje tonë, atëherë do ta zvogëlonin sadopak retorikën kundër Akademisë Mbretërore të Suedisë e kundër Peter Handkes. Dhe, do ta zvogëlonin sadopak këtë retorikë sepse institucion të mëkatshëm si ajo Akademi suedeze që jep Çmimin Nobel dhe individë të mëkatshëm politikisht kur më pak e kur më shumë se një Peter Handke do të gjenin edhe në historinë tonë të djeshme e mund të jetë edhe në historinë tonë të sotme.

Dëshën s'dëshën gojëtarët tanë kundër Akademisë Mbretërore të Suedisë dhe Peter Handkes do të shihnin politikanë e shtetarë shqiptarë të mes dy luftërave botërore, që do të përkrahnin Benito Musolinin, do të shihnin politikanë e shtetarë të mëparshëm shqiptarë, por edhe ndonjë krijues që do të merrnin pjesë në institucionet shtetërore fashiste, që do të krijojnë Duçejat në Shqipëri. E Duçejat, siç dihej, duke bërë dhunë e terror e krime luftime e krime kundër njerëzimit do të pushtojnë Etiopinë, disa pjesë të tjera të Afrikës, e mandej Shqipërinë dhe do të bëjnë lidhje politike, shtetërore e ushtarake me Hitlerin për pushtime më të gjera botërore! Gojëtarët tanë do të shihnin shkrimtarë shqiptarë, të çmuar, të adhuruar, të festuar e të stolitur me çmime të ndryshme se si e madhërojnë fashizmin dhe se si e bekojnë

Zotin për pushtimin e Shqipërisë prej kryefashistit Duçe!

Dhe, më tej, gojëtarët tanë kundër Akademisë Mbretërore të Suedisë do të harrojnë që të kërkojnë që shkollave, universiteteve, shesheve, rrugëve, institucioneve tona të ndryshme shtetërore t'u hiqen emrat e atyre adhuresve të fashizmit e atyre pjesëmarrësve në institucionet politike e shtetërore të pushtuesve fashistë!

Dhe, mbas kapitullimit të Italisë në vitin 1943 sytë e të mospajtuarve tanë me vendimin e Akademisë Mbretërore të Suedisë do të shihnin politikanë, shtetarë, shkrimtarë, krijues të tjerë shqiptarë se si e se sa do të përkrahnin nazizmin e Hitlerit, e Hitlerin si pushtues të ri të Shqipërisë e të Kosovës! Dhe, më tej! Dhe, më tej, çka do të shihnin në të djeshmen e në të sotme tonë gojëtarët tanë që tani e tri javë e ankojnë fort fatin e sivjetmë të Çmimit Nobel për letërsi në vitin 2019.

Do të shihnin disa shkrimtarë të sotëm shqiptarë, shkrimtarë shqiptarë të pas Luftës së Dytë Botërore, shkrimtarë e krijues të tjerë se si me gojë, me penë e me të dy duart e përkrahnin Josif Visarianoviç Stalinit dhe ideologjinë e politikën e tij të quajtur stalinizëm. E gojëtarët që po kërkojnë që Akademia mëkatore mbretërore suedeze t'ia anulojë Çmimin Nobel Peter Handkes do të duhej të dinin se Stalini nuk ishte më pak dhunëtar e gjakatar se Milloshi, do të duhej të dinin se ai, Xhugashvilli, e kishte përgjakur Bashkimin Sovjetik me gjakun e shumë qytetarëve të kombësive të ndryshme të Bashkimit Sovjetik; se i kishte mbushur burgjet me shumë intelektualë, shkrimtarë, shkencëtarë, krijues të tjerë, kurse jo vetëm një bashkësi etnike jo ruse e kishte dëbuar prej tokës së vet...!

Në qoftë se Peter Handke veprat e tij thjesht letrare artistike, nuk i ka "stolisur" me politikën dhe ideologjinë e Millosheviqit, por vetëm gazetarinë e publicistikën e tij, disa nga shkrimtarë tanë, qoftë edhe të sotëm, jo vetëm gazetarinë e publicistikën, po edhe veprat e tyre, sidomos veprat e tyre letrare, romanet, dhe tregimet, dhe dramet e tyre i kanë "stolisur" me emrin e Stalinit, me "gjenium" e Stalinit, me stalinizmin, me diktaturën e tij e me vizionin diktatorial që kishte ai për ardhmërinë!

Hajde, dy fjalë t'i them edhe për politikën e të ashtuquajturit diferencim ideopolitik pas demonstratave të rinisë sonë studentore e shkollore në vitin 1981 e më vonë. Jo vetëm politikanët po edhe sa shkrimtari, sa krijuesi tjetër, sa studiuesi shkencor janë detyruar ta përkrahin atë diferencimin ideopolitik duke i quajtur ato demonstrata - atë Hyrje të madhe të lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës, "kontrarevolucion, demonstrata armiqësore, kundër bashkim-vëllazërimit, që cenojnë rëndë të sotmen dhe të ardhmen e popullit shqiptar në Jugosllavinë socialiste vetëqeverisëse". Por, do të gjen den disa shkrimtarë e krijues të tjerë që shkonin vullnetshëm në mbledhjet e organizatave bazë të Lidhjes së Komunistëve për t'i dënuar ato demonstrata të quajtura "kontrarevolucion" e për t'i treguar me gisht ata që nuk diferencoheshin! E Millosheviqi me policinë e tij do të përdorë shumë dhunë e terror në Kosovë për shuarjen e idealit të atyre të treguarve me gisht, të atyre demonstratave, për burgosjen, dënimin a vrasjen e pjesëmarrësve në ato demonstrata!

Hajde dy fjalë t'i them dhe për udhëheqjen shumëvjeçare të partisë më të madhe fituese në zgjedhjet që mbaheshin në Kosovë me lejen e Sllobodanit e nën kujdesin e policisë së tij dhe në zgjedhjet që do të mbahen edhe mbas kapitullimit politik e fizik të Sllobodanit. Në valën e dhunës, terrorit, krimeve të luftës e krimeve kundër njerëzimit, kryetari i kësaj partie më të madhe e më jetëgjatë të Kosovës do të bëjë marrëveshje më 28 prill të vitit 1999 me zbatuesin besnik të politikës së Milloshit, në atë kohë kryetar i Serbisë, Millan Millutinoviç, për krijimin e Qeverisë kuslinge shqiptare. Dhe kjo marrëveshje tradhtarë do të nënshkruhet në ndërtesën e Kuvendit e të Qeverisë së dikurshme të Kosovës. Me atë rast solemn kryetari i partisë shqiptare do i çojë dhurata kriminelit Millan Millutinoviç! I njëjti kryetar i partisë më të madhe shqiptare në Kosovë, jo shumë kohë pas nënshkrimit të Marrëveshjes tradhtarë, kur ditët e Milloshit ishin të numëruara gjatë fushatës së bombardimeve nga forcat e NATO-s, do të shkojë në Beograd te Sllobodani dhe me të, në kabinetin e tij, do kalojnë në "bisedime paqësore" gjithë natën. Të nesërmen, i shoqëruar prej sigurimit të Sllobodanit, do të fluturojë për Itali prej Aeroportit të Beogradit! Dhe, atje, në Itali, do kërkojë ndërprerjen e fushatës së bombardimeve siç e kërkonte dhe Peter Handke! E të tjera të zeza dhe më të zeza! Dhe, këtë kryetar të partisë më të madhe shqiptare në Kosovë, partia e tij e tanishme me një pjesë të saj, e

fosilizuar, e feston, e madhëron, e mbarëkombëtarizon, e përgjithëson me konferenca e kongrese dhe me përndjekje të atyre që për të mendojnë ndryshe!

Në qoftë se i mendojmë të gjitha këto që i thashë dhe disa të tjera që, megjithatë, nuk i thashë ende, besoj se do ta lëmë të qetë Akademinë Mbretërore të Suedisë, Komitetin Nobel, dhe do ta pushojmë vajin për Çmimin Nobel!

Në qoftë se pajtohem me këtë propozim do të pajtohem edhe me një propozim tjetër: do të pajtohem se, se çmime të shumëçmuara të kohës së tyre nuk kanë marrë as Dante, as Bokaçio, as Servantesi, as Shekspiri, as Gëteja, as Balzaku, as Marsel Prusti, as Çarls Dikensi, as, as as! Se çmimin e sotëm Nobel nuk e kanë marrë as shkrimtari më i madh i kohës së tij Leon Tolstoi, as Henrik Ibzeni, as Xhejms Xhojsi, as Bernard Sho, as, as Andre Malro, as Horhe Luis Borhes, as Ignacio Silone, as Hulio Kortasari, as Nikos Kazanzakis. Por, o sa çudi, çmimi Nobel nuk i është dhënë as romansierit, teorikut e estetit më të madh botëror të gjysmës së dytë të shekullit 20 e të fillimit të shekullit 21, Umberto Ekos, por as shkrimtarëve të tjerë të mëdhenj botërorë Gilermo Kabrera Infantes, Filip Rotit, Mishel Turnies dhe Zhan d'Ormesonit. As, as, as sa e sa shkrimtarëve të tjerë vërtet të mëdhenj. E megjithatë as ata e as adhuruesit e tyre s'vajojnë për Çmimin Nobel e për çmime të tjera. Siç po vajojmë ne! Ne! Çmimet, si po shohim, sot, shumë më shpesh po jepen për angazhimet e letrarizuara politike të shkrimtarëve sesa për vlerat artistike të veprave.

Hajde, prandaj, t'i ndalim vajtimet e padinjitetshme rreth e rrotull Çmimit Nobel, t'i lëmë rehat Suedinë, Komitetin e Nobelit dhe Akademinë Mbretërore Suedeze dhe të mendojmë për tjetër çka: të mendojmë se si t'i parandalojmë shkaqet që po rrënojnë kohezionin shoqëror e mbarëkombëtar të popullit shqiptar - korrupsionin, nepotizmin, krimin e organizuar, padrejtësitë, papunësinë, varfërinë e madhe të një pjese të madhe të popullit, privilegjet dhe lukset e arrivistëve ndërgjegjeshuar, në të vërtetë të pandërgjegje, që kanë pushtuar pothuaj të gjithë sektorët e jetës sonë dhe konfliktet e pandalshme disaveçare të forcave politike!

Hajde, hajde, t'i parandalojmë këto të këqija shkatërruese të qenies sonë, se vetëm me parandalimin e tyre do ta ndalim degdisjen e të rinjve tanë, të ardhmërisë sonë nëpër rrugët e botës!



FILIGRANI PËRTEJ ARTIZANATIT

PRIZREN, 27 TETOR (ER) - OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Filigrani përtej artizanatit", financuar nga projekti "Dialogu ndërmjet komuniteteve përmes ruajtjes gjithëpërfshirëse të trashëgimisë kulturore", që implementohet nga UNDP dhe financohet nga Instrumenti i Bashkimit Evropian që kontribuon për Stabilitet dhe Paqe (IcSP), ka realizuar panairin "Filigrani përtej artizanatit".

Në këtë panair ishin të pranishëm përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve komunale, media, filigranistë nga vendi dhe rajoni si dhe qytetarë të shumtë.

Nga Komuna e Prizrenit i pranishëm ishte kryetari Mytaher Haskuka i cili tha se nisma të tilla janë të mirëseardhura dhe do të vazhdojnë ta kenë mbështetjen e kësaj komune edhe në vazhdimësi duke theksuar mbështetjen institucionale që kjo zeje të fuqizohet edhe të gjenden tregje të reja. Përfaqësuesit e UNDP-së treguan se ka interesim të madh që tregon sa është i rëndësishëm filigrani dhe se do të mundohen edhe në ardhmen të mbështesin projekte të tilla.

Në kuadër të këtij panairi u shfaq dokumentari i filigranit, ku u sqarua historikisht rrjedhoja e zhvillimit të këtij artiza-

nati në qytetin e Prizrenit. Zanatlinjtë e këtij artizanati në këtë dokumentar paraqesin mënyrën e punimit të zejes dhe ndajnë përvojën personale dhe sfidat me të cilat janë ballafaquar ndër kohë. Filigrani arriti në Kosovë rreth shekullit 15 dhe vlerat dalluese artistike e bëjnë atë një pjesë të çmueshme të trashëgimisë kulturore. Ky dokumentar shfaq, po ashtu, punën e realizuar nga 30 praktikantët të cilëve në kuadër të këtij projekti u është mundësuar të kalojnë nëpër një fazë të përvetësimit të aftësive të kësaj zeje.

Në këtë panair po ashtu u theksua fakti se deri më sot nuk ka ndodhur dokumentimi i këtij artizanati dhe ky projekt ka shërbyer si një përpjekje që filigrani të vazhdojë të mbahet gjallë dhe të dokumentohet. Pas shfaqjes së dokumentarit u mbajt një diskutim në një panel të përbërë nga: Bashkim Tejeci nga Prizreni, Sadbere Drishti nga Shkodra dhe Gordana Mitrovaska nga Shkupi.

Përfaqësuesja nga Shqipëria shpjegoi teknikën e punimit të filigranit në Shkodër dhe mënyrën se si po arrijnë ta mbajnë gjallë këtë zeje sot. Në anën tjetër, Bashkim Tejeci theksoi se është e nevojshme të bëhet një organizim shtetëror që do ta siguronte vazhdimësinë e filigranit në këtë qytet

duke mos lejuar të ndodhë ajo që tashmë ka ndodhur me shumë zeje që veçse janë shuar në qytetin e Prizrenit. Qëllimi i mjeshtërve si ai është që ta trashëgojnë atë të gjeneratave të reja, duke qenë se Prizreni i ka karakteristikat e veta në filigran dhe e sheh të domosdoshme që kjo punë të përcillet edhe në vazhdimësi. Ky zanat, theksoi ai, nuk ka pasur mbështetje më parë deri tani kur EC Ma Ndryshe, Komuna e Prizrenit dhe UNDP kanë ardhur me një projekt të tillë.

Edhe përfaqësuesja nga Maqedonia, Gordana Mitovska, theksoi se qëllimi i të gjithëve është që ta ruajnë këtë zanat nga zhdukja dhe të tërhiqen sa më shumë të rinjtë që t'i reken këtij arti. Kërkesë e saj është që të thellohet bashkëpunimi ndërmjet mjeshtërve të filigranit nga të gjitha vendet fqinje dhe u cek që sigurimi i jetëgjatësisë së filigranit duhet të futet në agjendën shtetërore meqenëse është problematike mbijetesa e tij duke marrë për bazë sfidat me të cilat përballen filigranistët tanë.

Pas këtyre diskutimeve pati një performancë me valle tradicionale nga ShKA Agimi dhe nga ShKA Sharski Behar dhe u shërbye ushqim tradicional prizrenas për të pranishmit. Mjeshtërit e filigranit patën mundësinë që eksponatet e tyre t'i shesin për të interesuarit.

RAPORTI I INSTITUTIT ZVICERAN PËR R

Gazeta "Epoka e re" në vazhdimë do t'i botojë dy raportet e përkthyer në gjuhën shqipe, njërin prej 44 faqesh dhe tjetrin prej 15 faqesh, të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës, për rastin e Astrit Deharit. Këto dy raporte tashmë i ka Prokuroria Themelore në Prizren, familja e Astrit Deharit dhe avokati Tomë Gashi. Raporti publikohet pa asnjë ndërhyrje.

Përkthimi i certifikuar nga gjuha frënge

Qendra universitare Ramond e mjekësisë ligjore
Njësia romande e mjekësisë feronizike
Chemin de la Vulliette 4, CH-100 Lausanne 25

Prof. Dr. mej. Tony Fracasso
Mjek shef, përgjegjës

Dre mjek Claudia Castiglioni
Mjeko ndihmëse, përgjegjëse për faqen e Lausanne

Tel.: 021 314 70 70
www.curml.ch

Lausanne, më 14 shtator 2019

N/ref : 19-T03497 – vic
V/ ref. PPN / I nr. 461/16

Ne kemi pranuar nga z. Metush Biraj, Prokuror kombëtar i Republikës së Kosovës, një pako të datës 5 shkurt 2018, në kudër të një kërkesë të ndihmës së ndërsjellë ndërkombëtare. Kjo pako i është drejtuar Qendrës Universitare Romand të Mjekësisë Ligjore me kërkesë për të ndërmarrë të gjitha hetimet e pavarura të nevojshme për të ndriçuar vdekjen e :

Z. DEHARI Astrit
I lindur më 26 shkurt 1990
I mbajtur në qendrën e paraburgimit në Prizren (Kosovë)
Vdekja konstatohet më 05 nëntor 2016 në 15:55

Ekspertiza jonë bazohet mbi:

Studimin e dosjes të lëshuar në procedurë (versioni në anglisht) të veçantë:

- o Kërkesë për Asistencë Juridike të Dyanshme në Çështjen Penale të 05 shkurtit 2018,
- o Raporti ("oficial memorandum") që përmbledh hetimet e drejtorisë së policisë rajonale të Prizrenit e pa datë,
- o Raportin e "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" të 30 nëntorit 2016 që ka të bëjë me tri regjistrime video,
- o Raportin e "Federal Entity of Criminology" të Ministrisë së Punëve të Brendshme austriake të 23 gushtit 2017 që lidhet me tri regjistrime video,
- o Raportin daktiloskopik të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" të 18 nëntorit 2016,
- o Raportin e ekspertizës gjenetike të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" të 25 nëntorit 2016,
- o Raportin e ekspertizës së grafologjisë të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" të 06 dhjetor 2016,
- o Raportin e ekspertizës psikiatrike të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës të 16 dhjetorit 2016,
- o Procesverbalet e audiencave,
- o Raportin e "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" për vendin e zbulimit të trupit të z. DEHARI Astrit,
- o Albumin e fotografive të vendit të zbulimit të trupit të z. DEHARI Astrit,
- o Raportin e autopsisë së z. DEHARI Astrit, të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës pa datë,
- o Videot e autopsisë së z. DEHARI Astrit, të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës",
- o Fotografitë e albumit fotografik të autopsisë së z. DEHARI Astrit "Agjencisë Kosovare të Forenzikës",
- o Fashikullin e "profil" të mbajtësit z. DEHARI Astrit sipas qendrës së qendrës së paraburgimit të Prizrenit pa datë,
- o Raportin e gjendjes psikologjike të paraburgosur z. DEHARI Astrit të datës 06 shtator 2016,
- o Raportin mbi historinë sociale të z. DEHARI Astrit sipas qendrës së paraburgimit në Prizren pa datë
- Një analizë e re dhe interpretimet:
- o Video dhe fotografi të autopsisë së z. DEHARI Astrit
- o Prerjet histologjike të autopsisë së z. DEHARI Astrit
- o Album fotografik të vendit ku është zbuluar trupi i z. DEHARI Astrit
- Studim të literaturës shkencore.

Ekspertiza jonë përbëhet nga :

- I. RIKUJTIME DHE FAKTE
- II. PËRMBLEDHJE E ELEMENTEVE TË PROCEDURËS
- III. ANALIZA TË REJA DHE INTERPRETIME TË DISA ELEMENTEVE TË PROCEDURËS NGA CURML
- IV. PËRMBLEDHJE DHE DISKUTIME
- V. PËRFUNDIMET
- VI. BIBLIOGRAFIA
- VII. VËREJTJE DHE PROPOZIME

(shkrimi në italik i tekstit) : vërejtjet e ekspertëve.

I. RIKUJTIME DHE FAKTE

Më 05 nëntor 2016, pak pas orës 15:00 z. DEHARI Astrit është gjetur i pajetë në qelinë A3 të qendrës së paraburgimit të Prizrenit në Kosovë, ku ai ishte mbajtur për terrorizëm dhe posedim ilegal të armës. I transportuar në spitalin rajonal të Prizrenit, vdekja e tij është konstatuar në ora 15:55 të njëjtën ditë.

Trupi i pajetë i z. DEHARI Astrit është gjetur nga tre bashkë të mbajturit, pas kthimit nga shëtitja në të cilën z. DEHARI Astrit nuk kishte dalë sepse ndjehej keq. Në momentin e zbulimit të trupit, z. DEHARI Astrit pushonte i shtrirë mbi tokë në shpinë, me një shishe mjalti prej plastike në gojë. Një autopsi mjeko-ligjore është kryer mbi trupin e pajetë të z. DEHARI Astrit në Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës. Raporti i autopsisë ka konkluduar për një asfiksion mekanike me obstrukcion të rrugëve respiratorë superiore me një objekt me qëndrueshmëri të fortë dhe me një ndalesë refleksi kardiak. Në mes tjerash, lëndimet në nivelin e qafës dhe të kyçit të dorës së majtë janë përshkruar si të vetë-shkaktuara. Në përfundim të hetimit, është përfunduar se z. DEHARI Astrit kishte kryer vetëvrasje duke u asfiksuar me një shishe prej plastike. Familja e të ndjerit, pasi që kishte dyshime mbi hetim paraprak, ka kërkuar që ekspertë mjeko-ligjor të zgjedhur nga ata vetë të jenë të pranishëm gjatë ekspertizës. Sipas mendimit të tyre, vdekja e z. DEHARI Astrit është pasojë e një asfiksion mekanike traumatike për shkak të një obstrukcion të rrugëve ajrore interne, të shkaktuara nga një shtypje e madhe me një objekt me qëndrueshmëri të fortë.

Në këtë kontekst, një pako është drejtuar në Qendrën Universitare Romand të Mjekësisë Ligjore (CURML) me kërkesë që të ndërmarrën të gjitha hetimet e pavarura të nevojshme për të hedhur dritë mbi vdekjen e z. DEHARI Astrit.

I. PËRMBLEDHJE E ELEMENTEVE TË PROCEDURËS

a. Kërkesë për asistencë juridike të dyanshme ndërkombëtare për çështjen penale të 05 shkurtit 2018

Një hetim është bërë nga "Basic Prosecution in Prizren", në departamentin e Krimeve të Rënda ("Department of Serious Crimes"), që lidhet me "vdekjen e dyshimtë" të trupit të pajetë të z. DEHARI Astrit, i cili, më 05 nëntor 2016 disa minuta pas orës 15:00, është gjetur pavetëdije në qelinë A3 të katit të dytë të qendrës së paraburgimit në Prizren. Vdekja e tij është konstatuar në ora 15:55, të njëjtën ditë, në spitalin rajonal të Prizrenit.

Në këtë çështje nuk ka asnjë të dyshuar.

Në kapitullin e deklaratës së fakteve aktuale në kërkesë, përmendet se: "vdekja e z. DEHARI Astrit ka ndodhur në lokalet e qendrës së paraburgimit në Prizren më 05 nëntor 2016 gjatë kohës së drekës (ang. "lunch time") të të burgosurve, pra ai nuk e ka marrë këtë racion (shënime të ekspertëve: sipas informacionit policor të përfshirë në pjesën tjetër të procedurës, ai e ka marrë këtë racion) dhe se ishte vetëm në qeli A3 në katin e dytë të qendrës. Pasi që përfundoi racionin, disa minuta pas orës 15:00, z. DEHARI Astrit është gjetur i pandjenja nga bashkë mbajtësit, i shtrirë mbi tokë në shpinë me një shishe prej plastike e mbushur përgjysmë me mjaltë, e vendosur thellë në gojë dhe fyte. Një ndihmëse ndihmë mjekësore emergjente i është bërë nga personeli i shërbimeve të qendrës së paraburgimit, pastaj z. DEHARI Astrit është dërguar në spitalin rajonal të Prizrenit, ku është konstatuar vdekja e tij rreth orës 15:55"

Në kapitullin që ka të bëjë me arsyet e dhëna për kërkesën e ndihmës ligjore, përmenden elementët e mëposhtme:

- Vendi i gjetjes së trupit (ang. "crime scene") dhe kamerat e sigurisë të qendrës së paraburgimit janë ekzaminuar nga "Criminalistics Technique Unit" të policisë së Kosovës.
- Kamerat e sigurisë janë ekzaminuar a posteriori nga ekspertët e "Federal Criminalistics Entity of the Federal Ministry of Internal Affairs" të Republikës së Austrisë.
- Janë realizuar marrjet në pyetje të dëshmitarëve okularë dhe dëshmitarë tjerë,
- Materiali i sekuestruar në vendin e zbulimit të trupit është marrë dhe analizuar,
- Një analizë grafologjike të dorëshkrimeve të trupit të pajetë të z. DEHARI Astrit është kryer,
- Një ekzaminim i këtyre dorëshkrimeve është bërë nga "Institute of Forensic Psychiatry",
- Ekzaminime serologjike dhe analizat e ADN-së janë bërë.

Pas analizës së kamerave të sigurisë, është konstatuar se dera e qelisë A3 ishte e mbyllur në vazhdimësi gjatë racionit dhe se dritarja e qelisë A3, e vendosur në 8 metra lartësi mbi tokë (shënime të ekspertëve: jashtë) ishte e mbyllur nga jashtë me një grilë metalike të paprekur.

Sipas konkluzioneve të departamentit të mjekësisë ligjore (DML) në Prishtinë, lëndimet e konstatuara mbi z. DEHARI në nivelin e qafës dhe të dorës kanë qenë të vetë-goditura nga

aspektet e ngurrimit, me ndihmën e një brisku rroje. Gjithashtu z. DEHARI kishte shkaktuar vetë asfiksion dhe asfiksion e vetë me një shishe prej plastike që kishte rezultuar në vdekjen e tij.

Familja e të ndjerit, pasi që kishte dyshime për profesionalizmin dhe objektivitetin e zyrtarëve që kishin udhëhequr hetimin paraprak, kanë kërkuar që ekspertë mjeko-ligjor të zgjedhur nga ata të jenë të pranishëm gjatë autopsisë. Sipas mendimit të tyre, vdekja e z. DEHARI Astrit është pasojë e një asfiksion mekanike traumatike për shkak të një obstrukcion të rrugëve ajrore interne, të shkaktuara nga një shtypje e madhe me një objekt me qëndrueshmëri të fortë. Ata e klasifikojnë këtë asfiksion si të dhunshme me bllokim komplet të rrugëve ajrore dhe një vdekje e shpejtë. Për ndryshe, ata përfundojnë për lëndime të simuluar (ang. "simulation damage") dhe lëndime në mbrojtje (ang. "self-defense signs") të dukshme mbi trupin e z. DEHARI.

b. Raporti (oficial memorandum) që përmbledh hetimet e Drejtorisë së Policisë rajonale të Prizrenit, pa datë

Policia e Kosovës është parajlmëruar më 05 nëntor 2016 rreth orës 15:25 se një i mbajtur në qendrën e paraburgimit në Prizren ishte i pavetëdijshëm. Rreth 15:55, policia është lajmëruar për vdekjen e të paraburgosurit në spitalin rajonal të Prizrenit. Me qëllim për të siguruar vendin e ngjarjes, hetuesit e "Regional Investigation Sector in Prizren" janë shkuar në vendin e ngjarjes rreth orës 16:20. Rreth orës 19:00 atyre u janë bashkëngjitur hetuesit e Directorate of Investigation of Serious Crimes in Pristina". Të mbajturit e qelisë A3 e vendosur në katin e dytë të qendrës së paraburgimit në Prizren, ishin : z. DEHARI Astrit, z. GASHI Adonis, z. MAKOLLI Naser dhe z. LASKI Frrok.

Z. DEHARI Astrit, ishte arrestuar nga policia e Kosovës më 30 gusht 2016 bashkë me aktivistë tjerë të lëvizjes vetëvendosjes (shënime të ekspertëve : parti politike) "LËVIZJA VETVENDOSJE" i dyshuar se kishte kryer një sulm terrorist kundër kuvendit të Kosovës më 04 gusht 2016.

Në 2014, i vëllai i z. DEHARI Astrit, z. DEHARI Arbnor, edhe ai aktivist i "LËVIZJA VETVENDOSJE" kishte bërë vetëvrasje në Prishtinë duke u hedhur nga dritarja e banesës, e vendosur në katin e 6^{te}.

Z. DEHARI kishte 9 raste kriminale dhe 4 vepra kriminale në bazën e të dhënave të policisë së Kosovës.

Më 05 nëntor 2016 në ora 11:58, racioni i drekës u ishte shërbyer të mbajturve, nënkuptuar këtu z. DEHARI. Në ora 12:43, të gjithë të mbajturit e qelisë A3 kishin shkuar në dush dhe janë kthyer në qeli. Në ora 13:53 të mbajturit kishin mundësi të shkonin në shëtitje. Nga qelia A3, fillimisht dy persona kanë dalë, pastaj i treti në veshje sportive dhe një kasketë. Gardiani (ang. "correctional officer") i është afruar qelisë A3 dhe e ka ngritur dorën. Sipas policisë, ky është shenja (ang. "it's understood") se personi i katër z. DEHARI, nuk dëshironte të shkojë në shëtitje. Roja menjëherë e ka mbyllë qelinë dhe me të mbajturit tjerë është nisur në drejtim të vendit të shëtitjes. Z. DEHARI e kishte informuar njërin nga të mbajturit (z. MAKOLLI Naser) se nuk dëshironte të shkojë në shëtitje pasi që nuk ndjehej mirë. Kur të mbajturit e qelisë A3 u kthyen nga shëtitja, e kanë hapur derën e qelisë dhe e kanë gjetur z. DEHARI me një shishe në

ASTIN E VDEKJES SË ASTRIT DEHARIT

gojë. Ata menjëherë kanë kërkuar ndihmë nga gardiani. Ky i fundit i ka ofruar ndihmën e parë emergjente dhe e ka informuar shërbimin e shëndetësisë të qendrës.

Sipas policisë, informatat e ofruara nga dëshmitarët bënin të ditur se z. DEHARI nuk dëshironte të shkojë në shëtitje pasi që kishte marrë një dush më herët dhe se kishte të ftohtë. Ai saktësisht kishte thënë se nuk ndjehej mirë, pa dhënë informata tjera.

Policia zbuloni sekuençën e ngjarjeve në vazhdim në regjistrimin video:

- 12:58 : Qelia A3 hapet për orën e racionit dhe 4 të mbajtur (pra edhe z. DEHARI) dalin nga qelia dhe marrin ushqimin e tyre.
- 13:41 : qelia A3 është e mbyllur.
- 13:50: të mbajturit dalin nga qelia për të shkuar në dush.
- 14:09: të mbajturit kthehen në qeli A3.
- 14:11 (06"): Një i mbajtur (*shënim i ekspertëve: identiteti nuk përmendet*) del nga qelia A3 në korridor, shikon dhe kthehet sërish në qeli.
- 14: 11(40"): gardiani e kontrollon qelinë A3, shikon a janë të mbajturit në qeli dhe e mbyll derën.
- 14:52 (00"): gardiani e hapë derën e qelisë A3.
- 14:52 (37"): dy të mbajtur dalin nga qelia A3.
- 14:52 (53"): një i mbajtur del nga qelia me një kasketë dhe veshje sportive.
- 14:53 (02"): "Të gjithë të mbajturit braktisin korridorin për shëtitje".
- 14:53 (22"): gardiani i afrohet qelisë A3 ngrit dorën sikur të përshëndeste dhe e mbyll derën (z. DEHARI Astrit nuk ka dalë nga qelia dhe duket se gardiani e përshëndet dhe e mbyll derën) [*shënim i ekspertëve: brenda kllapave në tekst*].
- 15: 53 (17"): qelia a3 hapet, njëri nga të mbajturit kthehet në qeli, ndërsa një tjetër ndalet në derë dhe flet me një të mbajtur tjetër.
- 15:53 (25"): janë shënuar disa "reagime" dy të mbajtur diskutojnë në derën e qelisë dhe të cilët z kthyen në qeli.
- 15:53 (28"): Vërehen reagime të të mbajturve që kërkojnë ndihmë.
- 15:53 (51"): gardiani arrin në qeli A3.
- 15:55 : tekniku mjekësor erdhi në korridor.
- 15:56 : tekniku mjekësor del nga qelia A3.
- 15:56 : një i mbajtur hyn në qelinë A3 me një shishe me ujë.

c. Raportin e "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" të 30 nëntorit 2016 që ka të bëjë me tri regjistrime video,

Një mision i ekspertizës ishte udhëhequr nga "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" për të ekzaminuar tri regjistrimet vide (DVD#1 HKVISION seria nr. 501062556 04; DVD#1 HKVISION seria nr. 522994844; DVD#1 HKVISION seria nr. 501062557 04) me qëllim të përcaktimit se a kishte intervenime apo interferenca mbi material. Konkluzionet e këtij raporti janë se ky institucion nuk disponon me pajisje dhe ekspertë të nevojshëm për këtë lloj veprimtarie.

d. Raportin e "Federal Entity of Criminology" të Ministrisë së Punëve të Brendshme austriake të 23 gushtit 2017

Një mision i ekspertizës ishte dërguar në "Federal Entity of Criminology" të Ministrisë së Punëve të Brendshme austriake me qëllim të verifikimit se mos kishte manipulim cilido qoftë në nivelin e tri regjistrimeve video [*shënim i ekspertëve: ne kuptuam se ka të bëjë me regjistrime që nuk kanë pasur mundësi të analizohen nga "Agjencisë Kosovare të Forenzikës"*]. Raporti i këtij institucioni saktëson se asnjë element nuk hedh në shesh manipulimin e videos.

e. Raportin daktiloskopik të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" të 18 nëntorit 2016

Një mision i ekspertizës ishte udhëhequr nga "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" për të ekzaminuar provat materiale (ang. "evidence") dhe për të përcaktuar praninë e gjurmëve digjitale mbi këto të fundit. Sipas këtij raporti, ekzistojnë gjurmë "linjave papilare" mbi pjesën e sipërme të shishes nga plastika (evidenca #5) dhe në sipërfaqen e brendshme dhe të jashtme mbi shishen e markës "SINBO" (evidenca #6). Gjurmë fragmentare të "linjave papilare" në veçanti ishin të dukshme mbi një orë me mbishkrim "Mowatch" (evidenca #19). Megjithatë këto gjurmë të "linjave papilare" nuk kishin karakteristikë individuale (anatomike) të mjaftueshme për një "punë plotësuese" (ang. "further work") [*shënime të ekspertëve: ne konkludojmë nga këto rezultate se gjurmët digjitale të gjetura mbi këto tri objekte ishin të papërdorshme*].

f. Raportin e ekspertizës gjenetike të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" të 18 nëntorit 2016,

Një mision i ekspertizës ishte udhëhequr nga "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" për të nxjerrë profilet e ADN-ve të të gjitha provave materiale (ang. "evidence") dhe t'i krahasojë me profilin ADN-së së z. DEHARI Astrit (#A.D). Sipas këtij raporti, profilet e ADN-ve të ngjashme me atë të z. DEHARI janë nxjerrë në pah tek provat materiale në vazhdim: një pambuk (ang. "swab"-#3), një peshqir i gjelbër (#4), një peshqir gri-jeshile (#4.1), një shishe plastike (#5), një shishe e markës "SINBO" (#6), një sapun ngj. trëndafili (#7), pambuktët (#9), një pambuk (#11), një sfungjer i rrethuar me një këmishë (#12), një paketim plastike me mbishkrim "Gillette" – MACH3", një brisk rroje (#13), një stilolaps me mbishkrim Ecolab (#14) një pambuk (#15). Asnjë përzierje gjurmësh nuk është identifikuar në bartësit e ndryshëm të analizuar.

g. Raportin e ekspertizës gjenetike të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" të 25 nëntorit 2016,

Një mision i ekspertizës ishte udhëhequr nga "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" për të nxjerrë profilet e ADN-ve të rrobave të bartura nga z. DEHARI Astrit në momentin e vdekjes së tij dhe të krahasohen me profilin e ADN-së së z. DEHARI Astrit (#A.D) Sipas këtij raporti, profilet e ADN-ve të ngjashme me atë të z. DEHARI janë nxjerrë në pah mbi rrobat : një palë pantallona

sporti (ang. A pair of lower parts of sport clothes - #A1), një "marcel" e bardhë (ang. under shirt - #A3) dhe brekë (ang. underpants - #A4). Asnjë përzierje gjurmësh nuk është identifikuar në bartësit e ndryshëm të analizuar. Raportin e ekspertizës së grafologjisë të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" të 06 dhjetor 2016,

h. Raportin e ekspertizës së grafologjisë të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" të 06 dhjetor 2016,

Një mision i ekspertizës ishte udhëhequr nga "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" për të krahasuar shkrimin e pranishëm në dorëshkrimet e marrë në qelinë A3 të qendrës së paraburgimit në Prizren (evidenca#22 dhe evidenca#G6) me shkrimin e të ndjerit z. DEHARI Astrit (materialin e njohur të z. DEHARI – evidenca #Astrit Dehari dhe#Fakulteti i Mjekësisë). Sipas këtij raporti dokumentet e analizuar paraqesin një shkrim që korrespondon me atë të z. DEHARI Astrit.

i. Raporti i ekspertizës psikiatrike të Institutit të Psikiatrisë forenzike të Kosovës të 16 dhjetorit 2016,

Një mision i ekspertizës i ishte dërguar Institutit të psikiatrisë forenzike të Kosovës, me qëllim të vlerësimit të gjendjes emocionale dhe psikologjike të të ndjerit z. DEHARI Astrit, duke u nisur nga këto shkrime. Ekipi i ekspertëve përbëhej nga këta anëtarë : Dr. Fahri Drevinja, neuropsikiatër; Dr. Ajert Bunjaku, psikiatër; Dr. Arife Veselaj, psikologe dhe Dr. Sc Gani Halilaj; neuropsikiatër, drejtor i institutit. Përfundimet e raportit janë në vazhdim:

- Nuk kishte nocion krize emocionale të rëndë as edhe shpërbërje të mëdha (ang. breakdown) emocionale,
- Nuk kishte shenja, të planit përgatitor për një "vizion negativ" (ang. "negative-sense" vision) në aspektin kriminal,
- Kishte një gjendje emocionale që ndryshonte kohë pas kohe në funksion të perceptimeve, të ditës, të situatës politike, të pritjeve, të frikës së kualifikimeve të shkeljeve dhe për të cilat, nganjëherë ai shprehte trishtim, pasiguri dhe një pesimizëm.
- Disa nga shkrimet reflektonin një gjendje emocionale sensibile dhe skeptike, që korrespondonte ndoshta me një gjendje emocionalisht të brishtë.

j. PROCESVERBALET E AUDIENCAVE

PV e audiencës së z. MAKOLLI Naser i 05 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.

Z. MAKOLLI tregon se gjendet në qendrën e paraburgimit në Prizren që prej 9 muajsh dhe ka një muaj e gjysmë që z. DEHARI ka ardhur në këtë qeli (A3). Në qeli, ishin katër të mbajtur: ai, Astriti, Frrok Leski dhe Adonis GASHI.

Z. MAKOLLI përshkruan se gjatë kësaj kohe sa ka kaluar me te, z. DEHARI, ishte gjithnjë i lumtur, i qetë, nuk paraqiste asnjë çrregullim, asnjë frikë as shqetësim dhe asnjëherë nuk e ka përmend se do të mund t'i bëj diçka vetvetes.

Z. MAKOLLI tregon se më 05 nëntor 2016, si çdo ditë, në ora 14:00 deri në 15:00, ata kanë dalë në shëtitje, por z. DEHARI ka qëndruar në qeli duke thënë se nuk ndjehej mirë. Kur ata janë kthyer nga shëtitja, rreth orës 15:00 ata e kanë gjetur të shtrirë mbi tokë, inertë. Ai kishte në gojë një shishe mjalti prej plastike. Ata menjëherë e kanë thirrë mjekun dhe janë informuar se kushte një puls. Ai shton se nuk ka parë gjake pranë trupit të tij dhe se vetëm ka parë plagë në njërin nga duart e tij. Z. MAKOLLI saktëson se nuk kishte brisk rroje as thikë në qeli.

PV e audiencës së z. MAKOLLI Naser i 09 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.

Z. MAKOLLI tregon se ishte më i afërt me z. DEHARIN se sa me tjerët e mbajtur. Ai tha se z. DEHARI kishte sjellje të mira, se ishte një djalosh i artë, ishte komunikativ, ai luante letra dhe tregonte barcoleta. Më 05 nëntor 2016 nuk ishte i mërziur dhe nuk kishte sjellje të pazakonshme.

Z. MAKOLLI tregon se nuk e di se a ka ngrënë z. DEHARI në gjatë racionit.

Z. MAKOLLI tregon se pasi që janë kthyer nga dushi, ata janë veshur dhe kanë diskutuar si zakonisht. Rreth orës 14:00 gardiani erdhi që t'u thotë se duhet të dalin. Tre mbajtësit tjerë kanë dalë dhe z. DEHARI ka thënë "unë nuk po vij sepse kam dhimbje koke dhe nuk po ndihem mirë". Z. MAKOLLI tregon se në vigjilje, z. DEHARI nuk ka dalë në shëtitje. Kur janë kthyer nga shëtitja, rreth orës 15:00, ai ishte i pari që hapi derën dhe e ka parë z. DEHARI të shtrirë në shpinë me duar të hapura, me shishen e mjaltit prej plastike në gojë. Kemi të bëjmë me një shishe që mund të blihet në kantinë. Në fillim ai ka besuar z. DEHARI bënte shaka, dhe përfundimisht, ai e ka kuptuar se ishte diç serioze dhe i ka parë gërvishtjet mbi dorën e tij të majtë. Menjëherë ka dalë nga qelia dhe ka kërkuar ndihmë. Atij nuk i kujtohet kush e ka largua shishen. Mjeku ka ardhur pas kërkesës së gardianit (Daut) [*shënim i ekspertëve: Z. KASTRATJ dhe ka thënë se z. DEHARI kishte puls ende*].

Vijon në numrin e ardhshëm

Merkeli dhe Erdogani bisedojnë për ofensivën turke në Siri

BERLIN, 27 TETOR - Kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, kanë biseduar për situatën në verilindje të Sirisë. "Ata janë pajtuar që të vazhdojnë të jenë në kontakt të ngushtë për këtë çështje", tha një zëdhënëse e qeverisë gjermane, e cila njoftoi për bisedën telefonike ndërmjet kancelares Merkel dhe presidentit Erdogan, por nuk dha më shumë detaje lidhur me

përmbajtjen e bisedës. Turqia ka kryer një ofensivë ushtarake në veri të Sirisë, me qëllim që t'i largojë nga ajo zonë luftëtarët kurdë, të cilët i konsideron terroristë. Koalicioni qeverisës në Gjermani ka pasur dyshime se si të përgjigjet lidhur me ofensivën turke. Socialdemokratët kanë kundërshtuar një propozim të ministres së Mbrojtjes, Annegret Kramp-Karrenbauer, që të krijohet një

"zonë e sigurt" nga Kombet e Bashkuara, në zonën kufitare Siri - Turqi.

Ofensiva turke në Siri është ndërprerë pas arritjes së një marrëveshjeje armëpushimi, të cilën e kanë ndërmjetësuar Shtetet e Bashkuara dhe Rusia.

Turqia dhe Rusia, po ashtu, kanë arritur një marrëveshje që t'i largojnë për 30 kilometra nga kufiri Turqi - Siri, luftëtarët kurdë.



Vritet lideri i Shtetit Islamik

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trumpi, njoftoi në një konferencë me gazetarë në Shtëpinë e Bardhë, se udhëheqësi i Shtetit Islamik Abu Bakr al-Bagdadi është vrarë gjatë një sulmi të qëllimshëm në veri-perëndim të Sirisë

UASHINGTON, 27 TETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, tha se udhëheqësi i Shtetit Islamik Abu Bakr al-Bagdadi, është vrarë pas një operacioni të forcave speciale ushtarake amerikane në Siri. "Mbrëmë Shtetet e Bashkuara sollën terroristin numër një në botë para drejtësisë", njoftoi presidenti Trump në Shtëpinë e Bardhë të dielën. "Asnjë personel amerikan nuk u dëmtua në operacion, por një numër i madh luftëtarësh të Bagdadit u vranë", njoftoi presidenti Trump të dielën nga Shtëpia e Bardhë, ka njoftuar voa. Ai tha se udhëheqësi i Shtetit Islamik ishte fshehur në një tunel nga u përpoq të ikte, "duke qarë dhe duke bërë turrë gjatë gjithë rrugës". Presidenti Trump tha se Bagdadi aktivizoi jelekun e tij me eksplozivë, duke vrarë tre fëmijë. Raportimet e medieve thanë se misioni në provincën Idlib të Sirisë përfshinte helikopterë, avionë dhe dronë amerikanë. Në korrik, një raport i OKB-së paralajmëroi se udhëheqësit e lartë të Shtetit Islamik "janë

mes atyre që kanë kaluar në zonën e Idlibit".

Vdekja e Bagdadit ishte raportuar gabimisht disa herë

Mesazhi i tij i fundit audio u lëshua në shtator, në të cilin ai premtoi se lufta kundër ShBA-së dhe aleatëve të saj është shumë larg fundit. Gjatë regjistrimit audio, më shumë se 30 minuta, ai thotë se ShBA-ja "tani po mbytet në kënetat" e Irakut dhe Afganistanit, duke shtuar se Uashingtoni është i pafuqishëm për t'i ndihmuar aleatët e tij në rajon dhe përrëth.

Që nga viti 2016, Shtetet e Bashkuara kanë ofruar një shpërblim deri në 25 milionë dollarë për informacione që ndihmojnë për ta sjellë Bagdadin para drejtësisë. Vetëm një person tjetër, udhëheqësi i al-Kaidës, Ayman al-Zawahiri, ka një shpërblim kaq të lartë.

Në mars të vitit 2014 gruaja e Bagdadit u la e lirë nga militantët e Frontit al-Nusra të lidhur



me al-Kaidën, së bashku me dy djemtë dhe vajzën e saj, në këmbim të 13 murgeshave të marra peng nga ai grup. Është raportuar se vetëm vajza ishte fëmija i Bagdadit. Të dy djemtë ishin fëmijët e gruas së tij, Sujidah al-Dulaimi, nga martesja e parë, përpara se të takohej me Bagdadin.

Bagdadi lindi në vitin 1971 në Samarra të Irakut. Ai u kap nga

forcat amerikane dhe u mbajt në kampin Bucca përgjatë kufirit Irak-Kuvajt mes vitit 2003 dhe 2009 para se të lirohej. Në vitin 2014 ai deklaroi krijimin e "Kalifatit" të Shtetit Islamik në Siri dhe Irak.

Vetë ISIS-i shumë shpejt pushoi pjesën më të madhe të Irakut dhe Sirisë dhe në kulmin e tij mund të ketë kontrolluar deri në 40 për qind të Irakut.

Në qershor të vitit 2017 qeveria irakiane shpalli fitoren ndaj ISIS-it në qytetin Mosul. Kryeministri irakian Haider al Abadi deklaroi fitoren e plotë ndaj grupit militant në dhjetor 2017. Në mars të vitit 2019 Forcat e Mbrojtjes Siriane, të mbështetura nga ShBA-ja, njoftuan çlirimin e Baghuzit, territori i fundit i mbajtur nga ISIS-i në Siri.

NATO-ja respekton stërvitjet e përbashkëta ushtarake të Serbisë me Rusinë

BRUKSEL, 27 TETOR - NATO-ja thotë se "respekton" vendimin e Serbisë që të mbajë stërvitje ajrore ushtarake me Rusinë, ku sistemet e mbrojtjes raketore ruse S-400 dhe Pantsir-S janë po ashtu pjesë e këtyre stërvitjeve. Rusia tha se sistemi S-400 dhe ai Pantsir-S po marrin pjesë në ushtrimet "Mburoja sllave 2019", që Moskë po zhvillon me Beogradin zyrtar, me qëllim që t'i testojë aftësitë mbrojtëse ajrore të të dyja vendeve. Ministria e Mbrojtjes së Rusisë tha se sistemet tokë-ajër janë vendosur në bazën në Batajnica,

që gjendet në periferi të Beogradit.

Është hera e parë që sistemet S-400 dhe Pantsir-S marrin pjesë në stërvitje ushtarake jashtë Rusisë, tha ministria.

Në një deklaratë dhënë për "Radion Evropa e Lirë", zyra për media e NATO-s tha se aleanca dhe Serbia "janë partnerë dhe ne respektojmë të drejtën e Serbisë që të ndërmarrë vendime sovraane lidhur me stërvitjet që kryen në territorin e saj". "Kjo është një çështje që i përket Serbisë dhe Rusisë", thuhet në deklaratën e NATO-s,

ku theksohet se "Serbia është partnere e NATO-s" dhe se vendet e Ballkanit "kanë një marrëdhënie të mirë dhe produktive" me aleancën perëndimore.

Sistemi S-400 do të kthehet në Rusi pasi të përfundojnë stërvitjet më 29 tetor.

Presidenti serb Aleksandar Vuçiq tha se sistemi Pantsir do të blihet nga qeveria e tij. Serbia ka marrëdhënie të mira politike dhe ekonomike me Rusinë, pavarësisht se thotë se qëllimi i saj është t'i bashkohet Bashkimit Evropian. Beogradi



është zotuar se do të qëndrojë jashtë NATO-s dhe ka refuzuar që t'iu bashkohet vendeve

perëndimore, të cilat kanë vendosur sanksione ndaj Rusisë për shkak të Ukrainës.



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333


E jashtëzakonshme

Transformon kungullin 450 kilogramë në një barkë

Një fermer ka transformuar një kungull të madh në një barkë për të kaluar një përrua. Justin Ownby nga Tennessee kishte kultivuar kungullin i cili arriti në peshën 400 kilogramë. Por në vend se ta shfrytëzonte për zbulim me rastin e festës së Halloweenit, Justini vendosi ta transformojë në një barkë. Bashkëshortja e tij e publikoi videon në rrjetin social "Facebook".



FOTO E DITES



Një aeroplan tregon një makinë që lëviz përgjatë një rruge afër fshatit Martkopi në Xhorxhia. /AFP/

E rrallë

Një hapësirë parkimi në Hong Kong shitet për rreth një milion dollarë

Hong Kongu është një kapital global financiar. Por, gjithashtu, është një vend ku mund të jetë më e kushtueshme për të mbajtur një makinë sesa të blesh një shtëpi. Një hapësirë parkimi prej 135 metrash katrorë është shitur nga një biznesmen për 969.000 dollarë. Hapësira e parkimit u shit më 24 tetor nga biznesmeni



Johnny Cheung, ndërsa identiteti i blerësit nuk dihet ende. Hapësira është përpara The Center, një kullë 79 katëshe në lagjen qendrore në Hong Kong.

BARSOLETA E DITËS



Profesori: - Hasan, nëse e do një notë kaluese, të paktën shkruaje në tabelë një fjali çuditëse!
Hasani: - Vetëm më thuaj a po ke dëshirë me u çudit ti a unë, se qysh të duash ta shkruaj.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.



DASHI


Kjo e diel do të jetë disi e trazuar

dhe e mbushur me tensione, ndaj bëni mirë që të shmangni diskutimet.



DEMI

Duhet të mundoheni që të qetësoheni, pasi së fundmi keni qenë shumë në ankth.



BINJAKËT

Ju pret një ditë pozitive gjatë së cilës mund të përfitoni për të sqaruar disa situata që vijnë të jen konfuze.



GAFORRJA

Kjo e diel do të jetë pozitive

lidhur me paratë dhe punën, sidomos për gjithë ata që kanë një aktivitet të tyre.



LUANI

Dashuria mund të jetë protagoniste e ditës, por duhet të bëni shumë kujdes, pasi nga njëra anë Hëna ju mbron dhe nga ana tjetër, Dielli, Mërkuri dhe Venusi, janë të kundërt.



VIJRGJËRËSHA

Kjo ditë do të jetë mjaft pozitive, por do të ndiheni nën ankth dhe frikë për të ardhmen.



PESHORJA

Ju pret një ditë shumë pozitive sa i takon dashurisë, ku një histori e mund të transformohet në diçka shumë të bukur.



AKREPI

Për të lindurit e kësaj shenje ka nisur një fazë e rëndësishme dhe e diela do të jetë mjaft pozitive.



SHIGJETARI

Kjo e diel do të jetë mjaft pozitive, ku tejet të favorizuara do të jenë raportet ndërpersonale dhe takimet me njerëz të rinj.



BRICJAPI

Kjo e diel do të jetë disi nën ritmin e duhur, ndaj përfitoni për tu qetësuar dhe për të menduar se çfarë dëshironi nga e ardhmja.



UJORI

Ju pret një ditë konfliktoale gjatë së cilës mund të dalin probleme në sferën sentimentale.



PESHQIT

Ndonjëherë diçka që sapo ka lindur, mund të shndërrohet në të rëndësishme krejt papritur.

Lirohet nga burgu aktorja e famshme



Aktorja e njohur Felicity Huffman është liruar nga burgu pasi vuajti dënimin prej 11 ditësh për skandalin e pranimit të nxënësve në kolegji. Huffman u la e lirë të premten që lamë pas nga një burg federal në Dublin të Kalifornisë. Ylli i

"Shtëpiakeve të Dëshpëruara" ishte e para nga më shumë se 30 prindër të akuzuar që vuajti dënimin. Ajo u deklarua fajtores për komplot pasi pagoi 15 000 dollarë që përgjigjet e provimit të vajzës së saj për pranimin në kolegji të korrigjoheshin fshehurazi në vitin 2017.

Selena Gomez: Dua që këngët e mia t'i dëgjojë Bieberin



Pasi Selena Gomez hodhi dy këngë të reja këtë javë, që të dyja në dukje i referohen marrëdhënies së saj së dikurshme me Justin Bieberin, këngëtarja pranon

që ajo do të donte që Justini t'i dëgjonte ato, veçanërisht baladën "Lose You to Love Me". "Po, unë dua që ai të dëgjojë", ka thënë Gomezi në një intervistë në Zach Sang Show.



Irina Shayk mëson vajzën të kalërojnë

Vajza e Bradley Cooper dhe Irina Shayk, Lea, duket e gatshme të jetë një yll në kalërim. Dytëvjeçarja e lezetshme u pa duke hipur në një kalë të madh me ngjyrë kafeje në Mike Meldman. Mbajtur me siguri të lartë në kalë nga nëna e saj, supermodeluesja me origjinë

ruse, Lea, me kaçurrelat e saj flokëverdhe rrezatonte derisa nëna e saj fliste në anglisht dhe rusisht. Shayk dhe vajza e saj ishin mysafire në festën e përvitshme të Rockit 'the Ridge të Silo Ridge', e cila përfshinë aktivitete si muzikë live, një mori ushqimesh, mini-golf dhe një kopsht zoologjik.

Gigi dhe Tyleri vazhdojnë të flasin me njëri-tjetrin



T Tyler Cameron dhe Gigi Hadid ende kanë marrëdhënie të mira. 26-vjeçari dhe modeluesja 24-vjeçare vazhdojnë të flasin me njëri-tjetrin edhe pas ndarjes së tyre, sipas një interviste të fundit të Tyler dhënë për Us

Weekly. "Ka qenë një botë ndryshe. Kur na duhet ne jemi miq", tha ai duke konfirmuar se ata të dy komunikojnë ende. Tyler dhe Gigi fillimisht u panë bashkë në muajin gusht, por dy muaj më pas u ndanë.

Historia e Iliaz Baznës, nje



Iliaz Bazna, i njohur si Elyesa Bazna, konsiderohet si spiuni më i famshëm turk. Ai erdhi në Turqi nga Kosova në fillim të shekullit XX, atëherë kur Perandoria Osmane po largohej nga Ballkani. Një film i ri turk tani thur legjenda të reja për Iliaz Baznën. Detaje mahnitëse nga një portret i botuar në gazetën gjermane "Süddeutsche Zeitung".

Manushaqet mbi varr janë ende të freskëta. Pak njerëz e dinë se në Mynih të Gjermanisë është i varrosur Iliaz Bazna, më saktë në "Grabfeld 97, Friedhof Perlacher Forst". Mbi pllakën e granitit mund të lexohet 'Cicero', e poshtë emri i burrit që për vete thoshte se ka qenë "spiuni më i madhi i Luftës së Dytë Botërore". Iliaz Bazna, emri sekret i të cilit ishte Cicero, u lind në vitin 1904 në Prishtinë, e vdiq në vitin 1970 në Mynih të Gjermanisë, ndër- sa po merrte rrogë nga asistenc- a e të papunëve.

Në vitin 1943 Bazna ishte shër- bëtor (sot do të thuhet: asis-

tent) i ambasadorit britanik në Ankara. Atëhere Turqia ishte shtet neutral dhe shumë shtete dëshironin ta kishin aleat, ta zëmë britanikët. Gjermanët synonin të kundërtën dhe kërcënonin se do të bombardonin Stambollin dhe Izmirin nëse Turqia i shpall luftë Rajhut të Tretë.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore kryeqyteti turk ishte plot e për- plot me agjentë - dhe Iliaz Bazna mendonte se i plotë- sonte kushtet më të mira për të qenë agjent. Atë nuk e rekrutoi askush, ai vetë ia shiti dijen e tij një shteti, Gjermanisë së Adolf Hitlerit, me të cilën në fakt nuk

e lidhte asgjë. Bazna nuk qe nazist, por ai e furnizoi regjimin hitlerian me doku- mentet më sekrete të shteteve aleate. Iliaz Bazna çdo mëngjes ia jepte burimit të tij pan- tallonat e hekurosura dhe xhaketën e shkundur dhe çdo mbrëmje pizhamet dhe një tabletë për gjumë. Po kush ishte burimi i tij? Ishte Hughe Knatchbull-Hugessen, ambasador i Britanisë së Madhe në Ankara. Pasi ambasadorin e zinte gjumi, Bazna i merrte dokumentet nga kasaforta që gjendej te shtrati i ambasadorit, i fotografonte ato në dhomën e shërbëtorëve dhe

i kthente te tavolina e vogël pranë krevatit. Ose e hapte arkën e diplomatit, dhe këtë e bënte me një çelës të riprod- huar. Bazna frikësohej se do të zbulohej. Po të ndodhte kjo, ai vështirë do të mbijetonte. Dokumentet që i kopjonte, Bazna ia dorëzonte ambasadorit gjerman në Ankara, Franz von Papen, i cili në fillim të viteve '30 ishte kancelar i Rajhut.

Përse i hyri këtij rreziku Iliaz Bazna? Ka versione të ndryshme - aventurë, lakmi për para? Tani filmi artistik turk 'Çicero' përpiket që spiunin ta shndërrojë në hero, i cili paskësh vepruar me urdhër nga lart. Nga fundi i filmit si skemë shfaqet Kemal Ataturku, themeluesi i Republikës së Turqisë. Ai ka vdekur më 1938, por filmi përpiket të na bind se Ataturku personalisht e ka urd- hëruar Baznën ta shpëtojë Turqinë nga 'lufta e ndyrë'. Sipas filmit, Bazna ishte një

anëtar i një 'organizate sekrete nacionale'. Bazna, rolin e të cilit e luan Erdal Besikçioğlu, një aktor bukurosh dhe i pop- ularizuar në Turqi, i përgjigjet Ataturkut: 'Zbatoj urdhrin, pasha im'. A thua Cicero ishte spiun turk? Agjent i dyfishtë?

Në filmin klasik të spiunazhit 'Five Fingers' të Joseph L. Mankieëicz, i cili u xhirua më 1952, ylli i Hollyööodit, James Mason, luan rolin e Ciceros, pra të Iliaz Baznës. Në këtë film Bazna i shpëton zbulimit duke ikur në Brazil. Pas luftës ai në Rio de Zhaneiro vazhdon jetën në luks deri kur zbulohet se paratë me të cilat e kanë paguar gjermanët nuk kanë asnjë vlerë. Janë para të falsifikuara. E vërteta është se Bazna nuk ka qenë kurrë në Rio, por futet bri- tanike që e kishte marrë nga gjermanët vërtet kanë qenë të falsifikuara. Paratë ishin shty- pur në kampin e përqendrimit Sachsenhausen në veri të Berlinit. Me falsifikimin masiv

riut të Hitlerit në Stamboll

shkruan veten si të shëmtuar, trupshkurtër, me hundë të trashë, në shikim të parë 'katundar' dhe të çorientuar. Por Bazna kishte një dobësi, një dobësi të madhe: i donte gratë, pa fund. Dhe pse në filmin turk, siç shkruan "Süddeutsche Zeitung", tregohet vetëm një lidhje amuroze e Baznës.

Iliaz Bazna nga Prishtina ishte burrë me talent. Kishte një zë të bukur, një zë bariton. Këndonte arie të Verdit, këngë të Schubertit, dhe kështu e entuziazmonte ambasadorin britanik. Me të dashurat e tij Iliaz Bazna shkante në dyqanet më të shtrenjta dhe kalonte kohën e lirë në hotelin Ankara Palas.

Kur Iliazi lindi në Prishtinë, vendi i tij ishte pjesë e Perandorisë Osmane. Kur më 1912 në Ballkan u shemb Perandoria Osmane, familja e Baznës iku në Selanik, pastaj në Stamboll, ku Bazna ndoqi mësimet në një shkollë ushtarake. Pas Luftës së Parë Botërore Stambolli ishte i pushtuar nga trupat britanike, italiane, franceze. Që në moshën 16-vjeçare Bazna u punësua në një njësi franceze të transportit, aty mësoi të drejtojë makinën. Veturat ishin pasioni i tij. Pasi shkaktoi një aksident me një motoçikletë të një oficeri, Baznën e futën në burg dhe një gjykatë ushtarake franceze e dërgoi në internim në Marsejë (Marseille). Atje Iliaz Bazna mësoi mirë frëngjisht dhe kështu, më vonë, i bëri përshtypje ambasadorit britanik në Ankara.

Në fillim gjermanët nuk i besonin Baznës. Ai ofronte dokumente britanike dhe kërkonte shumë para. Dikur Bazna arriti ta bindte Ludëig Carl Moyzisch, i cili në Ankara punonte si atashe për tregti, por në fakt ishte pjesëtar i drejtorisë për siguri të regjimit nazist në Berlin. Kur Bazna ofroi dokumente që dëshmonin se ku saktësisht do të bombardonin gjermanët në Ballkan, Moyzisch i premtoi se pas luftës Hitleri do t'i dhurojë atij një vilë. Dokumentet e Iliaz Baznës i bënë përshtypje ministrit të Jashtëm gjerman Joachim von Ribbentropit dhe kancelarit Adolf Hitler. Thuhet se Hitleri duke u bazuar në dokumentet e Iliaz Baznës në dhjetor 1943 kishte parashikuar pushtimin e aleatëve në pranverë të vitit 1944. Sulmi në Normandi filloi më 6 qershor 1944. Aleatët e quajtën aksionin 'Operation Overlord' - edhe këtë informacion Iliaz Bazna ia dha gjermanëve. Por fatkeqësia e tij ishte se tashmë nuk i besonin

në Berlin pasi agjenti Bazna kishte dorëzuar aq shumë dokumente, sa që ministria e Jashtëm e Ribbentropit besonte se fjala ishte për një kurth britanik. Shërbimi sekret britanik pas luftës deklaroi se Bazna ka qene nën kontrollin britanik, domethënë agjent i dyfishtë, por këtë britanikët mund ta kenë thënë për të ruajtur fytyrën. Në kujtimet e Baznës nuk gjendet asnjë dëshmi që ai ka qenë agjent i dyfishtë. Paratë që i merrte nga gjermanët Bazna i ruante nën qilimin e dhomës së tij. 300 mijë funt. "Më jepte ndjenjën e triumfit të madh të ecja mbi këto para me qëndrimin përulës të shërbëtorit besnik të zotërisë tim, shkëlqesisë së tij, ambasadorit britanik Hughe Knatchbull-Hugessen. Motivi i tij ishte triumfi i burrit të thjeshtë kundër perandorisë." - shprehej ai.

Më 1944 Bazna u largua nga ambasada britanike në Ankara.

Ishte i frikësuar se do të zbulohet. Qëndroi në Ankara, mori me një qira, gjeti një dashnore me të cilën harxhonte paratë e falsifikuara që kishte marrë nga gjermanët. Njëkohësisht kishte një grua me 4 fëmijë, të cilët i përkrahte me zemërgjerësi dhe për veten e tij thoshte: "Ndërgjegjja ime është e qetë". Pas Luftës së Dytë Botërore Bazna themeloi një firmë ndërtime dhe ndërtoi një hotel në Bursa, buzë kodrës Uludag. Në Bursa i pëlqente hoteli "Çelik", të cilin e kishte vizituar edhe Atatürku. Pranë këtij hoteli Bazna nisi të ndërtojë "Çelik-Palas", një "pikëtakim i botës", siç mendonte Bazna. Por me kalimin e kohës bankat zbuluan se paratë e Baznës qenë të falsifikuara. Hotelin "Çelik-Palas" e ndërtoi dikush tjetër, në galeri shihen fotografitë e vizitorëve të famshëm si Audrey Hepburn dhe Shahut të Persisë. Asnjë shenjë nuk tregon se ndërtimin e hotelit e ka

nisur Iliaz Bazna.

Pasi u zbulua se punonte me para të falsifikuara Iliaz Bazna iku në Stamboll. Në lagjen Laleli ai u tërhoq në një banesë të thjeshtë. U martua edhe njëherë, u bë baba i katër fëmijëve të tjerë. I përballur me varfëri, ai i shkroi kancelarit gjerman Konrad Adenauer dhe e luti për ndihmë, fundja ai kishte ndihmuar Rajhun e Tretë. Por në Gjermaninë e re askush nuk donte të dëgjonte për këtë, kërkesa e Baznës u refuzua.

Më 1960 Iliaz Bazna shkoi në Mynih. Gjeti një punë si rojtar nate - dhe e gjeti edhe biografin e tij. Mbi pllakën e varrit të tij gjendet edhe emri i një gruaje. Esra, para emrit titulli "dr.". Në kujtimet e tij Bazna shkruan se Esra ishte kushëriri e tij, të cilës ia kishte plotësuar një dëshirë: ia kishte paguar shpenzimet për studimet universitare. Ia kishte paguar me para të falsifikuara.



të funitit nazistët synonin të dëmtonin bankën e Anglisë.

Në kujtimet e tij Bazna tregon se nëpër çfarë 'rrugësh të çuditshme' kanë kaluar këto para - u nisën dhe përfunduan në Turqi: "Në fillim të luftës fabrikat turke të tekstilit eksportonin pëlhurë në Gjermani". Kjo pëlhurë pastaj shndërrohej në letër të ngjashme siç e përdorte banka angleze. Këtë Bazna e mori vesh pas Luftës së Dytë Botërore kur qe zbuluar se paratë që kishte marrë nga gjermanët ishin të falsifikuara. Dhe ku e kishte zbuluar? Në Stamboll.

Për të gjitha këto ai tregon në kujtimet e tij me titullin 'Unë isha Cicero'. Kujtimet e tij i ka shkruar autori gjerman Hans Nogly. Ato së pari u botuan në një revistë gjermane, pastaj dolën si libër në Lichtenberg Verlag. Në kujtimet e tij Bazna tregon se ishte i pangopur për të shijuar jetën, për të pasur para e pushtet. Bazna e për-

MBI DISA ÇËSHTJE TË TRADITËS SË SHKRIMIT DHE TË DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES

Nga: Eqrem ÇABEJ
(fjalimi i mbajtur në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972)

Kur Komisia Letrare e Shkodrës, në "Parimet e rregullat" që caktoi për drejtshkrimin e shqipes aty nga fillimi i vitit 1917, vendosi që zanorja ë e pathekse, grupet zanore ie, ue, ye dhe grupet bashkëtingëllore mb, nd e ngj do të shkruhen të plota ashtu si i ruan këto toskërishtja e pjesërisht dhe disa nëndialekte të gegërishtes, ajo mund të shtonte e të thoshte që ashtu të plota kanë ekzistuar ato dhe janë shkruar pak shekuj më parë në krejt truallin e gegërishtes dhe se janë të gjithmbarshme të gjuhës. Dihet se shkrimtarët e vjetër të Veriut, të shekullit XVI e XVII, gjer aty nga mesi i shekullit XVIII, Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frano Bardhi, Pjetër Bogdani, Gjon Nikollë Kazazi e të tjerë, ndër ta edhe ndonjë anonim, ruajtës të një tradite gojore e shkrimore të gjuhës, i kanë përdorur të plotë këta tinguj, këto grupe zanoresh e bashkëtingëlloresh, dhe se më anë tjetër këto ndihen dhe sot e kësaj dite në disa treva anësore e si të tilla më konservative të fushës dialektore të gegërishtes. Në kohën e shpërnguljes së elementit shqiptar për në Itali, i cili rridhte kryesisht prej krahinave jugore të vendit, disa nga tiparet

themelore të dallimit midis dialekteve kishin zënë vend me kohë në gjuhë, po më anë tjetër disa të tjera ndryshime që vërehen në shekujt e mëpastajmë, ende nuk kishin marrë rrugë; në vend të tyre ishin në përdorim fjalë, forma fjalësh dhe ndërtime fjalish të përbashkëta për mbarë gjuhën. Shohim kështu që midis gjuhës që përdor p.sh. Gjon Buzuku prej Veriu dhe asaj që shkruajnë arbëreshët e Italisë duke nisur me Lekë Matrangën prej Siqelie krahas me dallimet dialektore ka edhe pika takimi të shënueshme. Pika takimi të tilla vërehen edhe midis gjuhës së atij autori dhe dialekteve shqiptare të Greqisë, si edhe midis këtyre dialekteve dhe atyre të Italisë më njërën anë, dhe gjuhës të së tjerëve autorë të vjetër të Veriut më tjetrën anë. Shkurt pra, në këto variante gjuhësore të Veriut e të Jugut, dialektore e letrare, pasqyrohet kudo në vijat e saj të përgjithshme një shqipe e kalimit nga koha paraturke në kohën e parë të sundimit osman, nga perioda paraletare në periodën letrare. Është një njësi gjuhësore që manifestohet në variacione të shumëllojshme.

Për arsye të ndryshme të karakterit historik, ekonomik e social, me mungesën e një organizimi shtetëror të mirëfilltë e të një qarkullimi rrugor të rregullt, me shpërnguljet e brendshme të popullsisë sidomos prej

katundeve në qytete, me rrugët e ndryshme të marrëdhënieve tregtare, me kontaktet e pakta krahinë me krahinë, me dallimet fetare të reja që erdhën e iu shtuan dallimeve profesionale që ekzistonin qëmori në vend, për këto e për të tjera arsye, që është vështirë të gjurmohen në hollësitë e tyre, ligjërimet e ndryshme të shqipes në periodën osmane morën një rrugë jo aq afruese sesa më fort larguese, pra në një farë vështrimi një zhvillim më fort divergjent se konvergjent. Këtyre arsyeve të një karakteri të përgjithshëm jashtëgjuhësor vjen e u shtohet edhe një faktor i natyrës gjuhësore. Tradiita e shkrimit, e cila në kohët e para kishte marrë një hov të ri në Shqipëri, për disa rrethana të brendshme e të jashtme, më një anë për t'i vënë sadopak një ledh depërtimit të fuqishëm të islamizmit në vend, më anë tjetër duke u përfshirë në fushatën e Kundërreformës në Europë, vërtet se nuk u ndërpre krejt në periodën prej shekullit XVI gjer në Rilindjen letrare të shekullit XIX, si vazhdon të mendohet shumëkund gjer më sot, po megjithatë ra fashë në shumë pikëpamje. U kufizua më një anë në një letërkëmbim tregtar e privat, më anë tjetër në shkrime të hartuara me qëllime praktike të shërbimit fetar, më anë tjetër me disa shkrime letrare laike të një karakteri pak a shumë privat, që mezi qarkul-

lonin përbrenda disa rrethve shoqërore të ngushta. Asnjë nga këto shkrime, fetare e laike, nuk arriti të ngrihej në shkallën që të shihte dritën e botimit. Arsyet për këtë vetëm pjesërisht mund të kenë qenë të natyrës praktike, si do të ishin mungesa e shtypshkronjave dhe e mjeteve pekuniare. Arsyet kryesore e këtij shkimi mbrapa, e kësaj rënieje letrare do të kërkuar më fort në mungesën e një ideje sociale më të përgjithshme, e cila në çdo vend e në çdo kohë ka vënë njerëzit në lëvizje dhe ka gjetur mjetet e realizimit. Mungesa e një ideje të tillë bëri që këto shkrime mbetën qëllim në vetvete dhe nuk patën asnjë lidhje, asnjë konvergjencë në mes të tyre.

Gjuhët e përbashkëta të shkrimit e të literaturës zakonisht ndërtohen mbi një bazë dialektore të caktuar. Kjo ndërkaq përbën pikënisjen për një zhvillim të mëtejshëm, nuk merret e gjitha ashtu si është, në tërësinë gjuhësore konkrete të saj. Shpeshherë asimilohen në atë mes edhe elemente të ndonjë dialekti tjetër ose dialektesh të tjera, ndonjë nga tiparet fonetike, morfologjike, sintaktike a leksikore të tyre, të cilat vijnë e integrohen në sistemin e gjuhës së përbashkët, ose përndryshe shërbejnë si model për të modifikuar ndonjë tipar të kësaj, që si tepër i veçantë ndihet nevoja që t'i shtrohet një reformimi. Krahas me këto procese të një karakteri aktiv vërehet në atë mes edhe një proces i përkundërt, më fort negativ, i cili konsiston në këtë, që dialektet e tjera me kohë heqin dorë nga disa tipare vetiake të tyre, gjë që u hap rrugë formave të përgjithshme, lehtëson derdhjen e këtyre përrënjeve në lumin e përbashkët të gjuhës. Arsyet që determinojnë marrjen e një dialekti të caktuar si bazë të përbashkët të gjuhës së shkrimit mund të jenë të ndryshme, sikundër tregojnë edhe vëzhgimi i formimit të gjuhëve letrare të popujve të ndryshëm të Europës. Aty ndikon ku epërsia kulturore e sociale e një krahine të caktuar të vendit, ku pozita qendrore e një dialekti, ku ekzistenca e një tradite letrare të formuar, që nëpërmes të një shkrimtari a disa shkrimtarëve




me format arrin në një formë të përpunuar të gjuhës dhe bëhet kështu model për të tjerët, sikundër ndodhi p.sh. në Itali. Më shpesh vihet re ndërkaq se aty kanë çuar peshë si faktorë vendimtarë prestigji i një epërsie politike dhe të tjera arsye jashtëgjuhësore. Përgjithësisht mund të thuhet se zakonisht të gjitha këto komponente ndikojnë së toku në formimin e një gjuhe të përbashkët, natyrisht në shkallë e me përpjestime të ndryshme, ku më shumë njëra, ku tjetra.

Po të këqyret së këndejmi gjendja e shqipes si gjuhë shkrimi e literature, ajo mund të përvijohet shkurt në këtë mënyrë:

I pari dokument i datueshëm i gjuhës shqipe, Formula e Pagëzimit e vitit 1462, pra e epokës së Skënderbeut, në pajtim me rrethanat e kohës ruan një tipar dialektor të dallueshëm, shpirtit për "shpirtit" të ligjërimin të Matit. Duke kaluar te shkrimtarët e mëpastajmë, me Gjon Buzukun në krye, vihet re më një anë një shkallë mjaft e përpunuar e gjuhës, një gjuhë letrare, më anë tjetër një formë gjuhësore me tipare mjaft të përbashkëta, me gjithë ndryshimet lokale në trajtat e fjalëve. Këto rrethana flasin për dy sende: E para, që gjuha ka qenë shkruar edhe më parë, gjë që dëshmon shprehimisht që më 1332 arqipeshkvi i Tivarit Guillelmus Adae, i cili njihet dhe me emrin Brocardus. E dyta, që këta autorë nuk kanë shkruar në dialekt me kuptimin e mirëfilltë të fjalës, po në një formë mbidialektore të gjuhës, në një farë koineje të Shqipërisë Veriore, me pikësynim që shkrimet e tyre të ishin të kuptueshme për





një masë më të hapët besimtarësh. Kjo shihet qartë nga karakteri mjaft konvergjent i gjuhës së tyre, megjithëse ata rridhnin, sikundër dihet, prej krahinash së ndryshme të kësaj treve. Vetë dubletat që ndeshen në veprën e Buzukut, kun dhe kon, ordhënit e ordënit, lem edhe letë, thanë e thashunë etj., tregojnë që ky autor herë ngrihet në një formë gjuhësore më të përgjithshme, herë binte në ligjërimin lokal të vetin; kurse te pasardhësit e tij lëkundjet janë më të rralla, norma gjuhësore paraqitet e ngulur më mirë, ka shkuar më përpara.

Duke kaluar përsipër fazës së një fare amullie që u ravizua më lart dhe duke ardhur në shekullin XIX, shihet se idetë e shekullit të dritës (shekullit XVIII) dhe ato të romantizmit nisnin e përhapen dhe në Shqipëri edhe në diasporën shqiptare. Romantizmi, i cili në Europën Juglindore u shtri më vonë, në një kohë kur në Perëndim kishte zënë fill natyralizmi, në këto vise, në pajtim me kushtet sociale e politike, zhvilloi më fort anën nacionale. Ndihej në zgjimin e ndjenjës së kombësisë, në vlerësimin e gjuhës amtare, në dashurinë për poezinë popullore dhe në përpjekjet për mbledhjen e saj, shumëkund nën shtysën e ideve të Herderit rreth vlerave të këngës popullore europiane. Në trevën shqiptare pemët e para të kësaj lëvizjeje mendore, e cila këtu ndërkaq u ushqye edhe me ide të shprehura që më parë nga disa fuqi të vendit, u dukën së pari, që në gjysmën e parë të atij shekulli, tek arbëreshët e Italisë me Jeronim De Radën në krye. Shkrimtarët e Rilindjes e çuan më tej këtë lëvizje dhe e ngritën në një shkallë nacionale. Për mbledhjen e folklorit pak u bë,

me përjashtim të "Bletës shqipëtare" të Th. Mitkos; po ç'u la mënjanë në këtë fushë, u kompensua më së miri me anën letrare e gjuhësore. Visaret e ligjërimin popullor zunë të mblidhen e të hyjnë në literaturë, më anë tjetër gjuha letrare u pasurua me leksema të reja, pjesërisht të marra prej gurrës popullore ashtu si ishin, pjesërisht të farkuara kryesisht me lëndë gjuhësore të vendit, edhe pse shpeshherë si kalke, si përkthime, pas gjedhes së gjuhëve të tjera, përbrenda kuadrit të leksikut modern ndërkombëtar. Nuk është vendi këtu të shtjellohet në hollësitë e saj puna e kryer në këtë drejtim prej K. Kristoforidhit, J. Vretos, N. Frashërit, S. Frashërit, më vonë prej F. Konicës, F. Nolit, L. Gurakuqit e të tjerëve. Vetëm do të përmendet që Tahir Boshnjaku prej Gjakovës që më 1835 shtiu në përdorim disa fjalë si mësues, nrxanës, digues, dis, folës, kallxues, shtis, e të tjera si pështim, randim, rrënim, rrëzim, të cilat me të tjera rrugë u bënë pastaj pronë e leksikut abstrakt të gjuhës shqipe. Duke e shikuar punën e kryer prej shkrimtarëve të shekullit të XIX në tërësinë e saj, shihet se ka një vijë zhvillimi në thelb të pandërprerë që nga tradita letrare e shekujve të mëparmë, një rilindje të vërtetë të asaj tradite të vjetër, edhe m'anë tjetër një fill të pakëputur që shpie në rrethanat e sotme. Po të shtrohet pyetja nëse në formimin e një gjuhe të përbashkët sidomos në shkrim, ka marrë pjesë në një masë më të madhe veprimtaria gjuhësore-letrare apo komponentja e fuqive jashtëgjuhësore, për Shqipëri përgjigjja është kjo, që – si në shumicën e vendeve të Europës – shtysa kryesore erdhi nga ana

e këtyre fuqive. E ngritur që më parë në një shkallë më të lartë të përdorimit dhe e gatitur për një zhdrivillim të mëtejshëm nga puna e kryer në shekullin e kaluar, shqipja mori formë si gjuhë shkrimi me tendencë për njësim në të ardhmen, kryesisht që prej themelimit të një shteti shqiptar e këtej, që kur ajo u bë shprehje e një njësie shtetërore të centralizuar. Kjo gjë gjeti pasqyrimin e saj dhe në shkrim dhe në drejtshkrim, në fushën fonetike poaq sa në leksik, dhe u zhvillua përherë e më shumë në këto fusha. U arrit me kohë në njësimin e disa trajtave fonetike e gramatikore, në ndjekje të rregullave të Komisionit Letrare të Shkodrës dhe të Kongresit të Lushnjës të vitit 1920. Puna më e madhe aty u krye ndërkaq në pasurim të visarit të fjalëve. Me rrethanat e reja që u krijuan u desh të plotësoheshin nevojat e gjuhës së administratës e të fushave të tjera të veprimtarisë shtetërore, të ekonomisë, të teknikës, të arsimit e të kulturës, të sferës ushtarake etj. Për hir të së vërtetës duhet të thuhet se kjo punë jo e pakët, më shumë se prej personalitetesh të njohura, e prej shkrimtarësh e studjuesish të gjuhës, u krye prej masës anonime, prej nëpunësish të thjeshtë, administratorësh, juristësh, arsimtarësh, ushtarakësh, teknikësh degësh të ndryshme e prej së tjerësh. Një pasurim më i tejshëm e shumë më i madh se më parë u arrit ndërkaq në ditët tona, kur pas çlirimit të vendit mori përmasa të reja industria, arsimit, dija, ekonomia, bujqësia, teknika e të tjera degë të veprimtarisë njerëzore. Për të rrokur me një vështrim këtë rrugë zhvillimi në rrjedhë të disa brezave, mjafton të krahasojmë Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954 me atë të

Hahnit që është i vitit 1854, ose dhe me atë të Kristoforidhit të vitit 1904. Aty shihet përparimi që është arritur në pasuri të fjalorit jo vetëm në një shekull, po edhe brenda një gjysmëshekulli.

Një gjuhë e përbashkët, përtej caqeve shtetërore, mbetet shprehja e një njësie nacionale dhe e një shkalle të caktuar të kulturës së bashkësisë që e flet. Përpjestimi aty është i karakterit të drejtë, në mënyrë që sa më e fortë të jetë ajo njësi, sa më e ngritur ajo shkallë kulture, aq më e formuar paraqitet gjuha e përbashkët, si në të folur dhe sidomos në shkrim. Një gjuhë e tillë qëndron kështu përmbi mbidialektore, në një farë vështrimi emëruesi i përbashkët dhe sinteza e tyre. Ajo paraqet një realitet dhe njëkohësisht rezultatin e një farë abstrakcioni, të formuar gjatë kohës, në mënyrë që nuk përputhet krejt me një dialekt territorial të caktuar, as edhe me dialektin që përbën bazën e saj. Sikundër u tha edhe më lart, gjuha e përbashkët e shkrimit edhe lë jashtë ndonjë element të këtij dialekti, edhe përvetëson me kohë elemente të dialekteve të tjera. Në këtë mënyrë kjo gjuhë bëhet një njësi brenda ndryshimeve. Duke qenë ajo edhe treguesi i shkallës së kulturës të një populli, një popull i kulturuar ndër të tjera dallohet edhe për një gjuhë shkrimi të formuar e të njëjshme.

Në dallim nga gjuha e folur e nga dialektet e saj, e cila si më e lirë, më shpejt kalon nëpër ndryshime në kohë, gjuha e shkrimit, si shprehje e një kulture që është, i mbahet një tradite. Ajo ka përgjithësisht një karakter konservativ, me të cilin ushtron bile një ndikim përmbi gjuhën e folur duke ngadalësuar ritmin e ndryshimeve që kjo pëson. Ky karakter i saj përcaktohet nga disa rregulla, të cilat në tërësinë e tyre përbëjnë drejtshkrimin e një gjuhe. Ato janë më të ngulëta se rregullat nëpër të cilat përshkohet gjuha e folur dhe bëhen gjithmonë e më të ngulëta, më të qëndrueshme, sa më shumë të marrë formë gjuha e shkrimit dhe e literaturës. Sa më fort kjo t'i afrohet njësimin, aq më shpejt zhduken në atë mes dhe përjashtimet nga rregullat, format dyjare të fjalëve e të trajtave gramatikore. Rregullat drejtshkrimore rrjedhin nga një realitet, e ky është shkalla e zhvillimit që ka arritur gjuha si tërësi në një cak kohe të caktuar. Drejtshkrimi duhet t'i përgjigjet këtij realiteti.

E shikuar nga këto pikëpamje parimore, forma e shkruar e shqipes, si ajo e përdorimit të përditshëm, si ajo e nivelit letrar, që prej kohësh kur dëshmohej së pari me shkrim, paraqitet me një vijë zhvillimi, e cila karakterizohet nga një aksiomatikë e caktuar.

Aksioma e parë është që kjo formë gjuhësore gjatë përdorimit të saj është thjeshtuar gjithmonë e më shumë në trajtat e sistemit fonetik e gramatikor dhe është pasuruar në visar të fjalëve. Ky proces vazhdon dhe sot e kësaj dite, duke shkruar gjuha më një anë drejt thjeshtimit, më anë tjetër drejt pasurimit.

Aksioma e dytë është konvergjenca. Rregullat e drejtshkrimit ndaj tërësisë së këtij janë të krahasueshme me gurët e veçantë me të cilët ngrihet një ndërtesë; dhe si këta gurë, edhe ato rregulla kanë vendin edhe peshën e vet si elemente përbërëse të një tërësie. Po peshë kryesore në këtë mes ka tërësia. Nuk është pa rëndësi që një fjalë e caktuar e shqipes të shkruhet me një ë të pathekse më pak ose më shumë, me një r të fortë ose të thjeshtë, me l palatale apo velare, me sh a me ç në pozicion nistor, dhe për këto çështje e të tjera si këto po diskutohet që t'u japim rrugë përbrenda mundësive të sotme. Po qenësore, esenciale në këtë mes, në dallim nga periodat e mëparme të historisë së shkrimit të shqipes, është që vija e zhvillimit gjuhësor shkon drejt konvergjencës. Dhe ajo shkon në thelb vetvetiu, në pajtim me ligjet e brendshme të gjuhës. Ky proces nuk mund të çmohet kurrë mjaft në rëndësinë e tij. Ai ka për të vepruar më tej edhe në të ardhmen.

Aksioma e tretë përmban njëkohësisht edhe një rregull. Gjuha e shkrimit ka dalë në analizë të fundit prej gjuhës së gjallë të popullit që e flet. Në pajtim me këtë, edhe rregullat që përcaktojnë përdorimin e saj duhet të dalin nga të dhënat e këtij realiteti gjuhësor. Gjuha popullore përbën rrënjën që ushqen në mënyrë të pareshtur gjuhën e shkrimit. Kur kjo largohet nga ligjërimi popullor, largohet njëkohësisht dhe nga masat popullore, dhe rrezikon të bëhet një gjuhë letre, një gjuhë artificiale. Në qoftë se gjuha e shkrimit saj nga të folët popullor theksohet edhe më tepër, me kohë paraqitet mundësia e një diglosie, një dygjuhësie, gjë që ka ndodhur në disa gjuhë të botës, edhe të Europës. Për disa arsye sociolinguistike, të cilat nuk është vendi të shtjellohen këtu, edhe kalimi nga dialektet teritoriale në gjuhën e shkrimit duhet të jetë i ngadalshëm e i harmonishëm. Gjuha e shkrimit nuk duhet të jetë dialektofobe. Mbetet një fakt në atë mes që ligjërimi popullor me gjithë shtresat e ndryshme që e përbëjnë, me karakterin e tij të natyreshëm e të thjeshtë, është i caktuar të jetë një gurrë e gjallë ku përtërihet vazhdimisht dhe gjuha e literaturës.

Duke hyrë në disa pika të veçanta, në lidhje me vijat parimore që u ravizuan më sipër, do të thuhet se janë arritur rezultate të mira, disa pika të qëndrueshme, në shkrim të shqipes në drejtim të thjeshtimit e të konvergjencës. **(Vijon)**

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Ballkani udhëheq Superligën, '89-shi sërish fitimtar ndaj Gjilanit



Ballkani i Ismet Munishit tregohet i pagabueshëm ndaj Dukagjinit sikurse edhe Drita ndaj Ferizajt. Gjilani ndalet për të dytën herë në këtë edicion nga Trepça '89. Java e dymbëdhjetë mbyllet sot (e hënë) me ndeshjen derbi në mes të dy skuadrave nga kryeqyteti, Prishtinës dhe Flamurtarit

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 28 TETOR - Skuadra e drejtuar nga Ismet Munishi, Ballkani, e mposhti Dukagjinit me rezultat 3-0 dhe tash është lidere e IPKO Superligës së Kosovës në futboll. Skuadra nga Suhareka tre golat e fitores i shënoi në pjesën e parë ndaj Dukagjinit të Klinës, kurse golashënues ishin treshja e rrezikshme Blend Baftiu, Arbër Hoxha dhe Jetmir Topalli. Pas tri pikëve të reja, Ballkani është në vendin e parë me 26 pikë, kurse Dukagjini mbetet i fundit me 7 pikë. Kjo humbje ishte e nënta në këtë edicion për skuadrën e Dukagjinit dhe arsyeja pse trajneri Xhengis Rexhepi dha dorëheqje nga detyra e trajnerit.

Ballkanit nuk i ndahet Drita, e cila e fitoi përballjen me Ferizajn (0-2) dhe tash ka vetëm dy pikë më pak të grumbulluara. Pjesa e parë në Ferizaj përfundoi 0-0, kurse goli i parë u shënua pas një ore lojë, kur Bujar Shabani e mposhti portierin vendës për rezultatin 0-1. Dhjetë minuta më vonë Betim Haxhimusa e vulosi rezultatin final (0-2) dhe në këtë mënyrë gjilanasit ia kthejnë borxhin Ferizajt për humbjen në ndeshjen e xhiros së parë. Humbje befasuese pësoi Gjilani në fushën e vet nga Trepça '89 (0-2). Mitrovicasit e kishin fituar edhe përballjen e parë në "Riza Lushta" me rezultat 4-1 dhe në këtë mënyrë shtoi

jmë dominimin në përballjet direkte me skuadrën që synim e ka titullin e kampiones. '89-shi dy golat e fitores i realizoi brenda pesë minutave për t'i marrë pikët e plota në përballje me Gjilani. Shënues ishin Arb Manaj dhe Engjel Hoti. Gjilani mbetet në kuotën e 24 pikëve dhe zë pozitën e tretë në renditjen tabelore, kurse Trepça '89, që drejtohet nga Shpëtim Idrizi, është e teta me 16 pikë të grumbulluara.

Drenica dhe Vushtrria i hakmerren Feronikelit dhe Llapit

Me rezultat 4-1 i kishin fituar ndeshjet e para në këtë edicion Feronikeli dhe Llapi ndaj Drenicës, përkatësisht Vushtrrisë. Mirëpo të shtunën ndodhi e kundërta, pasi dy skuadra humbëse në ndeshjen e parë kanë realizuar fitore me rezultat 1-0 dhe në këtë mënyrë i janë hakmarrë për humbjet në xhiron e parë. Në minutën e pestë Qemail Elshani e realizoi golin e fitores për skuadrën e Drenicës, e cila tash ka 17 pikë dhe zë vendin e shtatë, derisa "Nikli" është një pozitë më lart me vetëm dy pikë më shumë. Fitore para tifozëve të vet ka regjistruar edhe Vushtrria, që ka arritur ta mposhtë Llapin (1-0). Golin e vetëm në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Ferki Aliu" e realizoi Eri Lamcaj në minutën e 26.

Sot zhvillohet derbi i kryeqytetit

Ndeshja e fundit për javën e 12-të në IPKO Superligën e Kosovës në futboll zhvillohet të hënë nga ora 18:00. Në stadiumin "Fadil Vokrri" takohen Prishtina dhe Flamurtari, kurse synim i "bardhekaltërve" është fitorja në mënyrë që të mbesë në hap me skuadrat e para. Rezultat pozitiv kërkon edhe Flamurtari, që renditet në pjesën e poshtme të tabelës me vetëm 9 pikë. Ndeshja e parë në mes të këtyre skuadrave kishte përfunduar 1-1.

IPKO SUPERLIGA

Ballkani - Dukagjini	3-0
Gjilani - Trepça '89	0-2
Ferizaj - Drita	0-2
Vushtrria - Llapi	1-0
Drenica - Feronikeli	

Të hënë takohen:
18:00 Prishtina - Flamurtari

TABELA

1. Ballkani	12	26 pikë
2. Drita	12	24
3. Gjilani	12	24
4. Llapi	12	20
5. Prishtina	11	20
6. Feronikeli	12	19
7. Drenica	12	17
8. Trepça '89	12	16
9. Ferizaj	12	9
10. Flamurtari	11	9
11. Vushtrria	12	9
12. Dukagjini	12	7

Në xhiron e radhës takohen: Gjilani-Ferizaj, Trepça '89-Vushtrria, Llapi-Drenica, Feronikeli-Ballkani, Dukagjini-Prishtina, Flamurtari-Drita.

LIGA E PARË

Vllaznia (P) ? Ulpiana	4-2
Arbëria ? Vëllaznimi	3-0
Malisheva ? Drenasi	1-0
2 Korriku ? Liria	2-1
Dardana ? Istogu	1-1
Besa ? Ramiz Sadiku	2-0

Të hënë takohen:
KEK-u ? Onix
Vitia ? Trepça

TABELA

1. Liria	11	21 pikë
2. Istogu	11	21
3. Malisheva	11	19
4. Arbëria	11	19
5. Besa	11	18
6. Drenasi	11	16
7. Vllaznia	11	16
8. Dardana	11	16
9. Trepça	10	15
10. Onix	10	13
11. Ulpiana	11	12
12. Ramiz Sadiku	11	11
13. KEK-u	10	10
14. 2 Korriku	11	10
15. Vitia	10	9
16. Vëllaznimi	11	5

SHKURT

Marian Ilievski, trajner i KB Rahoveci

KB Rahoveci ka konfirmuar se trajner i ri i skuadrës është emëruar Marian Ilievski. "Klubi i Basketbollit Rahoveci ka kënaqësinë ta konfirmojë arritjen e marrëveshjes me trajnerin e njohur nga Maqedonia, Marian Ilievski, i cili do ta drejtojë skuadrën tonë deri në fund të edicionit", thuhet në konfirmimin e "Vreshtarëve". 44-vjeçari është emër i njohur në basketbollin e Kosovës, pasi e ka fituar titullin me Prishtinën, derisa dy herë ka fituar Ligën Ballkanike me Prishtinën dhe klubin maqedonas Blokotehna.

Rashica shënon ndaj Leverkusenit

Milot Rashica ka pasur një performancë të mirë në ndeshjen që Werder Bremeni e luajti baras ndaj Bayer Leverkusenit (2-2). Repreruesi i Kosovës shënoi në minutën e 40. Golin tjetër për Bremenin e realizoi Davy Klaassen, kurse për Leverkusenin shënuan Omer Toprak autogol dhe Lucas Alario.

Sërish shënon Berisha

Sulmuesi nga Kosova, Besart Berisha, po gjen formën e tij më të mirë dhe ka shënuar golin e tij të dytë në tri ndeshje në A-League. Berisha realizoi në minutën e 66 teksa u tregua i saktë nga pika e bardhë e penalltisë. Por, goli i Berishës nuk mjaftoi për ekipin e tij të Wester Unitedit, pasi Melbourne City triumfoi me shifrat 1-2.

Muriqi s'ka të ndalur në Turqi

Vedat Muriqi është kthyer në një lojtar shumë të rëndësishëm për Fenerbahçen ku ndeshje pas ndeshje po vërteton formën e tij. Sulmuesi i Kosovës ka shënuar edhe në fitoren 5-1 që klubi ka arritur kundër Konyasporit. Muriqi ka shënuar deri më tani pesë gola dhe ka ndihmuar Fenerin që të renditet në vend të dytë me 17 pikë, një më pak se Alanyaspori.

Sigal Prishtina regjistron fitoren e pestë radhazi

Sigal Prishtina ka shënuar fitoren e pestë radhazi në Superligën e Kosovës në basketboll, duke mundur Trepçën me rezultat 105:71. Kjo ishte fitorja e pestë radhazi për prishtinasit, pas asaj humbje në xhiron e parë nga Rahoveci, derisa mitrovicasit pësuan humbjen e katërt, kurse kanë një fitore. Faktikisht ndeshjen më mirë e nisën mysafirët që e fituan çerekun e parë 23:27, por vendësit u kundërpërgjigjën në periodën e dytë, 29:15, kurse edhe më bindës ishin në periudhën e tretë 27:10. Deri në fund nuk kishte ndryshime të mëdha dhe Prishtina regjistrohen fitoren e pestë në Superligë, duke qenë lidere.

Rexhepi jep dorëheqje pas humbjes së nëntë

KLINË, 27 TETOR - Dukagjini e regjistroi humbjen e nëntë në IPKO Superligën e Kosovës pasi pësoi nga skuadra e Ballkanit (3-0). Xhengis Rexhepi ka dhënë dorëheqje nga detyra e trajnerit të skuadrës nga Klina. Ai ka thënë se pas rezultateve negative ndien përgjegjësi morale të japë

dorëheqje, kurse ka shtuar se janë munduar që me dinjitet të mbrohen ngjyrat e klubit. "Të nderuar miq, media dhe dashamirë të futbollit. Pas rezultateve negative në drejtimin e KF Dukagjini ndiej përgjegjësi morale të jap dorëheqje. Me dinjitet dhe karakter jemi munduar t'i mbrojmë

ngjyrat e klubit, në pjesën dërrmuese të ndeshjeve kemi qenë ekip më i mirë, por në futboll nuk mjafton të luash mirë, duhet të fitosh. Kriza dhe rezultatet negative kanë qenë vetëm në tabelë. Sa i përket lojës, kemi luajtur shumicën e ndeshjeve shumë mirë, rastet e humbura, shtyllat, gabimet që janë

bërë ndaj klubit nuk mbahen në mend, ndeshjet e mirë harrohen, syri i njeriut shikon vetëm rezultatin final", ka shkruar Rexhepi në profilin e vet në "Facebook". Rexhepi në fund ka falënderuar drejtuesit e klubit, tifozët "Hithat", si dhe kryetarin e komunës së Klinës, Zenun Elezaj.



Houstoni shijon fitoren e parë, Toronto triumfon ndaj Chicagos

HOUSTON, 27 TETOR - Pas humbjes në startin e kampionatit ndaj Milwaukee Bucksit, Houston Rockets është rikthyer të fitojë në ndeshjen e dytë radhazi në "Toyota Center", teksa mposhti jo pa vështirësi New Orleans Pelicansin me rezultat 126-123. Vendësit u shfaqën mjaft mirë në fraksionin e parë të ndeshjes, duke vënë një distancë prej pesë pikësh, por reagimi i Pelicansit ishte mjaft i mirë në dy pjesët e radhës, duke përmbysur rezultatin. Megjithatë, Hardeni me shokë u zgjuan në fraksionin e fundit, të cilin e fituan 29-23 dhe morën triumfin e parë sezonal. Brandon Ingram i New Orleans Pelicansit ishte lojtari i ndeshjes me 35 pikë, 15 rikuperime dhe 5 asistime, ndërsa te vendasit spikatën Hardeni dhe Westbrook me 57 pikë, 14 rikuperime dhe 18 asistime të dy së bashku. Kampionët në fuqi të Toronto Raptorsit morën fitoren e dytë në ndeshjen e tretë të këtij sezoni, teksa fituan bindshëm 84-108 në transfertën ndaj Chicago Bullsit në "United Center" të Michiganit. Kanadezët dominuan në të gjithë ndeshjen, por ishin veçanërisht superiorë në fraksionin e tretë, të cilin e fituan me 14 pikë diferencë, ndërsa më i miri i ndeshjes ishte kamerunasi Pascal Siakam me 19 pikë, 6 rikuperime dhe 4 asistime. Ka marrë fitoren e parë sezonale edhe Cleveland Cavaliersi që mposhti në shtëpi Indiana Pacersin me rezultat 110-99, në një sfidë fati



i së cilës u vendos në fraksionin e dytë, ku vendësit ishin fantastikë dhe fituan me shifrat 39-20. Në "Rocket Mortgage FieldHouse" të Clevelandit ishte Tristan Thompson ai që u shpall më i miri i ndeshjes me 25 pikë dhe 13 rikuperime, por një lojë mjaft të mirë bënë edhe Kevin Love e Collin Sexton për Cavs, ndërsa Indiana Pacers duhet të presë ende për fitoren e parë sezonale. San Antonio Spurs vuajti jo pak në përballjen me Washington Wizardsin në "AT&T Center", por shfrytëzoi maksimalisht faktorin fushë dhe fitoi me rezultat 111-122, për ta regjistruar suksesin e dytë në po kaq ndeshje të sezonit, të dyja të luajtura në shtëpi. Pas gjysmës së

parë të lojës, gjithçka ishte e barabartë, ndërsa diferenca u bë në fraksionin e tretë me Spursin që fitoi 32-30 dhe u mbrojti në pjesën e fundit që përfundoi në barazim 2-2 dhe bëri që vendësit ta marrin fitoren e dytë radhazi. LaMarcus Aldridge ishte më i miri i ndeshjes për San Antonio Spursin, me 37 pikë, 9 rikuperime dhe 3 asistime, ndërsa nuk mbeti pas as DeMar DeRozan me 36 pikë, 4 rikuperime dhe 3 asistime. Në sfidat e tjera, Atlanta Hawks fitoi me rezultat 103-99 ndaj Orlando Magic, Philadelphia 76ers triumfoi 111-117 në transfertën ndaj Detroit Pistonsit dhe Boston Celticsi mposhti bindshëm New York Knicksin me rezultat 95-118.

Marquezi triumfon në Australi

CANBERRA, 27 TETOR - Edhe pse e ka arkivuar çështjen e titullit kampion bote, Marc Marquez nuk ndalet në botërorin e MotoGP të këtij viti. Piloti spanjoll që po shkruan faqe të tëra në historinë e këtij sporti fitoi garën e Australisë duke regjistruar suksesin e 11 sezonal. Menjëherë pas tij u renditën Kal Kraclou dhe australiani Xhek Miller me këtë të fundit që regjistroi podiumin e tij të parë në klasën mbretërore të Botërorit të Motoçiklizmit. Në Filip Ajlënd, Marquez, që shënoi edhe fitoren e pestë radhazi në kampionat, përfitoi edhe nga rrëzimi i bashkëkombësit të vet Maverik Vinjales në xhiron e fun-



dit për ta marrë këtë fitore. Dy pilotët italianë, Andrea Dovizioso dhe Valentino Rosi, nuk shkuan më shumë se vendi i

shtatë dhe i tetë, ndërkohë që para tyre u pozicionuan Bangnaia, Joan Mir dhe Andrea Iannone.

SHKURT

Ndalet Teuta, Bylisi kap vendin e parë

90 minuta shumë përplot "luftë" ndërmjet Bylisit dhe Teutës u mbyllën me rezultat 0-0. Një barazim i merituar për mënyrën se si shkoi ndeshja dhe luftën e fortë sportive. Ndeshja e një niveli të kënaqshëm me të dy ekipet që u shprehën mirë në fushën e lojës. Teuta ishte më e rrezikshme në fushën e lojës, por nuk ia doli të kthehej te fitorja pas disfatës në Laç, raporton "Telesport". Djemtë e Shkëmbit gabuan në ato raste që patën, ndërsa në fund të ndeshjes Arapi tronditi traversën e vendësve. Përfundimisht, një 0-0 që nuk ndihmon asnjë nga ekipet për pretendimet e tyre në tabelën e klasifikimit. Bylisi kap Partizanin në vendin e parë me 17 pikë, por me një ndeshje më shumë, ndërsa Teuta ka një pikë më pak.

Fitojnë Trepça, Prishtina dhe Kastrioti

Ndeshje e fortë është luajtur në palestrën "Minatori" në Mitrovicë ku u përballën Trepça dhe Prizreni. Fitore në ndeshjen e javës së gjashtë të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt) ka shënuar Trepça me rezultat 36:28. Dallimi është bërë në pjesën e dytë, ndërsa pjesa e parë përfundoi me një gol epërsi në të mirë të Prizrenit, 17:16. Maxhera e Neziri kanë shënuar nga shtatë gola për mitrovicasit. Te Prizreni, që po konsolidohet dhe po paraqitet gjithnjë e më mirë, më efikas ishte Mehmeti me 10 gola. 6 herë realizoi Zherka. Trepça renditet e katërta me 7 pikë, kurse Prizreni është i nënti me 2 pikë. Ndërsa Prishtina e Kastrioti nuk kanë lejuar befasi. Prishtina është përforcuar në vend të parë me 12 pikë, pas fitores që e shënoi si mysafire e Vushtrrisë me rezultat 33:25. Kastrioti në Ferizaj ka fituar ndaj Drenicës me 37:32. Pikët e para i fitoi Vëllaznimi që në Gjilan e mposhti Dritën me 46:29.

Behrami është pa klub, por kërkohet nga Roma

Roma është një nga skuadrat që po vuan më së shumti nga lëndimet pasi Bryan Cristante, Lorenzo Pellegrini, Henrikh Mkhitarjan dhe Amadou Diawara janë mesfushorët e lënduar të Romës. Kjo ka bërë që "Giallorosët" të kërkojnë një mesfushorë dhe emrat si Jack Rodwell dhe Marcel Buchel ishin për teste mjekësore te Roma, por duket se nuk e kanë bindur klubin italian. Kryeqytetasi tani kanë kontaktuar mesfushorin shqiptar Valon Behrami i cili momentalisht është pa klub. Behrami shkëputi kontratën me Sionin pas mosmarrëveshjeve me klubin dhe është i lirë.

Messi: Ronaldo, sulmuesi më i mirë

Ylli i Barcelonës, Leo Messi, e ka vlerësuar ish-sulmuesin brazilian Ronaldo si sulmuesin më të mirë në botë. "Ronaldo ishte fenomen. Ai ishte sulmuesi më i mirë që kam parë nga të gjithë sulmuesit. Ishte i pabesueshëm", ka thënë Messi. Lidhur me të ardhmen, Messi ka deklaruar: "Nuk po mendoj të largohem nga Barcelona. Kam një ëndërr që të luaj për Newell's, por nuk e di a do të ndodhë. Kam një familje që vjen para dëshirave të mia".

Liverpooli në garë për Mbappen

Kylian Mbappe duket se do të largohet nga Paris Saint Germain në fund të këtij edicioni. Sulmuesi francez është bërë objektivi i shumë skuadrave të mëdha evropiane që duan transferimin e tij. Së fundmi garës i është futur edhe kampioni në fuqi i Evropës, Liverpool. "The Reds" ka fituar gjyqin me New Balance dhe pritet të marrë disa milionë euro dëmshpërblim. Gjiganti anglez pritet të nënshkruajë kontratë me "Nike"-n ku do të bëhet një nga skuadrat më fitimprurëse në botë. Kjo ka bërë që Liverpooli të interesohet për transferimin e francezit Mbappe dhe "Nike" mund t'i ndihmojë në këtë drejtim. Liverpooli është gati të shpenzojë rreth 300 milionë euro për transferimin e francezit në "Anfield". Gjithsesi ky transferim nuk do të jetë i lehtë pasi në garë për lojtarin janë edhe skuadra të tjera të mëdha si Real Madrid, Manchester United, Juventus e Barcelona.

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Habib Berisha" Gurbardh

Komuna: Malishevë

Data: 28.10.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/052-CS/1.1	Realizimi i orëve praktike mësimore përmes vizitave

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Habib Berisha" Gurbardh, Malishevë.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulentëve të nevojshme:

Për:

Realizimi i orëve praktike mësimore përmes vizitave**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve të natyrës së ngjashme;
- Përvojë në Realizimi i orëve praktike mësimore përmes vizitave
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatesisht vozitës të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e shërbimit për Realizimin e orëve praktike mësimore përmes vizitave të monumenteve, institucioneve dhe vendeve me rëndësi edukative e arsimore.

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e realizimit të vizitave mesimore për nxënësit (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përgjendhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përgjendhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **SHFMU "Habib Berisha" Gurbardh, Malishevë**, më së largu deri më **05.11.2019**.

Firmat e interesuara të konsulentëve mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Bekim Berisha
Telefoni: 045/637-411
E-maili: beki_12_1@hotmail.com

Shtojca 5:**Njoftimi për shprehje të interesit**

Emri i shkollës: SHFMU "GRNÇARE" - Grnçaredhe Novo Sello,

Komuna: Prizren

Data: 28.10.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/085-CS/1.1	Trajnim i mësimdhënësve

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "GRNÇAR" Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

Trajnim i mësimdhënësve Microsoft office Power Point (ne Prizren)

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 1 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën Adresa e Shkolles SHFMU "GRNÇARE" - Grnçaredhe Novo Sello, Prizren më së largu deri më 05.11.2019.

4. Termat e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Adis Mujo
 Telefoni: 044 355 049
 E-maili: adismujo@hotmail.com

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Ruzhdi Xhyliqi"-Marali

Komuna: MALISHEVË

Data: 28.10.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/055-CS/1.3	Trajnim: për mësimdhënës në Gjithëpërfshirje

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Ruzhdi Xhyliqi" Marali - Malishevë.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulentëve të nevojshme:

Trajnim për mësimdhënës në Gjithëpërfshirje**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvojë në trajnimin dhe punën me mesimdhënës
- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve të natyrës së ngjashme;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet, vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatesisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e trajnimeve profesionale;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e trajnimit të mesimdhënësve (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%)
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përgjendhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përgjendhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuara që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Ruzhdi Xhyliqi" Marali-Malishevë**, më së largu deri më **05.11.2019**.

Firmat e interesuara të konsulentëve mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Refki Hoxha
Telefoni: 044/564/575
E-maili: refkihoxha2@outlook.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Fleta Musaj shpall te pavlefshme dëftesat shme "Ymer Prizreni " Prizren

► Sabajdin Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Bajram Curri" Krush e Madhe

► Myrvet Kryezi shpall te pavlefshme dëftesat e kp I - VIII shf "Mic Sokoli" Lubiqev.

► Kërkoj shporet për nxehe qendrore me dru të përdorur, që mundet të ngrohe deri 1000 m2, numri kontaktues 044-608-626.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotësuar të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC COLA
Columbus, Georgia, USA
Since 1909